



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Marketing”, me profile, “Turizëm”, “Inovacion”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh”, “TV Multimedia”, "Marrëdhënie Publike Politike"

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

“Universiteti Europjan i Tiranës ”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Ermelinda KORDHA

Dr. Ana BUHALJOTI

Shkurt / 2020

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËMTË PROGRAMIT

Programi i studimit Master Profesional në Marketingme profile ofrohet për studentët nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit pranë Universitetit European të Tiranës (UET).

Insitucioni i Arsimit të Lartë, jopublik, "Universiteti European i Tiranës", është krijuar me Vendimin Nr.636, datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti European i Tiranës" si dhe të programeve të Studimit të Ciklit të Parë". "Universiteti European i Tiranës" ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.12, date 07.04.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022.

Ky program studimi është licencuar fillimisht si program Master i Nivelit të Parë (MNP) në: Marketing me profilet: "Shërbime dhe turizëm", "Inovacion dhe tregje strategjike" dhe "Marketing bankar e financiar", me VKM Nr. 74, datë 21.01.2009 i cili realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatje normale 1 vit akademik. Pas ndryshimit të ligjit është konvertuar në Master Profesional. Me urdhër të Ministrit Nr. 68, datë 14.02.2011, është akredituar si Master i Nivelit të Parë në Marketing me tre profile. Duke u mbështetur në hapësirën ligjore të krijuar me ndryshimet në legjislacionin e ri për arsimin e lartë, të rrjedhura nga Ligji Nr 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, për vitin akademik 2018-2019, ky program studimi ofrohet i përshtatur dhe me emërtimin e ri si Master Profesional në: "Marketing", me profile, "Turizëm", "Inovacion", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh", "TV Multimedia", "Marrëdhënie Publike Politike", në përputhje me Urdhërin e MASR Nr.664, datë 12.10.2018.

Programi i studimit Master në "Marketing me profile", plotëson në përgjithësi kriteret sa i takon rëndësishëm së programit për nevojat e ekonomisë, organizimit dhe administrimit të tij nga një staf i kualifikuar, nga kompetencat që ai përcjell, si dhe sa i takon mësimdhënies, mësimnxënies, si dhe plotësimit të burimeve të nevojshme për realizimin me cilësi të programit të studimit

Karakteristikat e këtij programi përmblidhen si më poshtë:

- Rëndësia e këtij programi ka lidhje me një fushë që po zhvillohet sot brenda ekonomisë dhe biznesit dhe kërkon profesionistë të aftë për t'i përgjigjur kërkesave të tregut në shumë sektorë, fusha e marketingut. Studentët e këtij programi priten të jenë një burim i rëndësishëm ekspertësh/specialistesh, por do të plotësojnë nevojat qëvlerësohet të ketë tregu shqiptar në disa sektorë, kryesisht shërbimesh, të cilat po rriten shpejt në kohët e sotme, si Turizmi, TV e multimedia, Marrëdhënie publike, etj;
- Ky program ka një qasje të ofertës me kërkesënnë tregun shqiptar të punës, për shkak të prirjes në rritje të kërkesës për profesionistë marketing në fusha të ndryshme të aktiviteteve ekonomike, por sidomos edhe të lidhur me aktivitete si inovacioni që po bëhet një prirje zhvillimi në sektorët lidhur me teknologjinë si dhe në sektorë të tjera;
- Programi Master profesional në "Marketing" me profileka si karakteristikë vendosjen e profileve krahasuar me programe të tjera, profile të cilat paraqesin një oportunitet për tregun e punës dhe lidhjen e studentëve që në fillim të studimit me një sektor apo profesion duke e komunikuar përmes titujeve të profileve. Por nga ana tjetër ato paraqesin



edhe një sfidë për të realizuar një formim sa më profesional vetëm me një numër të kufizuar lëndësh/kursesh gjë që kërkon precizion në identifikimin e objektivave formuese të programit dhe studim tregu lidhur me prirjet për vitet në vijim. Ndryshime të shpejta në treg do të duhet të sillnin programin në ndryshime të cilat jo gjithnjë janë të mundshme lidhur me lëndët e profileve;

- Përmes lancimit të këtij programi dhe tashmë testimit të tij në treg, ky program **rrugëton dhe mbështet mundësinë e profilizimeve dhe aftësive të tjera me të specializuara** që mund të ofrohen në të ardhmen nga ky departament dhe mund të përbëjnë një bazë të mirë për zhvillim në të ardhmen, nëse shfrytëzohen si duhet.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm paraqitet si një proces që ka ndjekur hapat rigorozë të cilat janë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë dhe gjithë bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë(ASCAL). Procedura përfshiu fillimisht kontaktin me ekspertët dhe grupin e Vlerësimit të Jashtëm GVJ, të cilët janë trainuarparaprakisht me standartet e cilësisë dhe kriteret, si edhe me përdorimin e sistemit elektronik në pjesën e panelit të ekspertit. Vendosja e një komunikimi të mirë në grupin e punës midis ekspertëve dhe menaxherit teknik nga ASCALështë rëndësishme për ecurinë e procesit. Pas njohjes dhe shfrytëzimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni për diplomën përkatëse, u ndërtua një agjendë përvizitën në institucion dhe hapi i radhës natyrshëm ishte realizimi i saj. Agjenda u zbatua me rigorozitet, duke ndikuar pozitivisht në mbledhjen dhe grumbullimin e informacioneve të mëtejshme të cilat ndikuan në një vlerësim bazuar mbi informacion sa më të detajuar. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Ermelinda Kordha, dhe Dr. Ana Buhaljoti. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Pas vizitës në terren u realizua raporti përfundimtar nga ekspertët e jashtëm dhe ky u dorëzua për rishikim nga ASCAL dhe për njohjen me të të GVB.

Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 31.01.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 9/16 Prot, datë 31.01.2020. Universiteti Europian i Tiranës përcjell pranë ASCAL më datë 13.02.2020, nëpërmjet shkresës me Nr. 06/10 Prot, datë 13.02.2020, “*Komente për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin MP Marketing*”, komente mbi draft reportin. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japid argumentat si më poshtë:

1. Lidhur me komentin që bëhet për Vlerësimin Përfundimtar të Programit, si një program që përmbush “**kryesisht**” kriteret, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në rapport**. GVJ nuk bën përllogaritje matematike, përndryshe duhet ti vendosnim pesha kritereve. Vlerësimi i GVJ kriteret plotësohen ‘**plotësishët**’, do të ishte në rastin kur do plotësoheshin 100% kriteret. Për më tepër përqindjet nuk mund të gjykohen në total, por për secilin standart. GVJ gjykon se nëse ka pak kritere që nuk përmbushen, atëhere, standarti nuk mund të përmbushet plotësisht, por në shkallën e parë më të ulët nga maksimalja.



2. Lidhur me komentin që bëhet për standartin 1.3, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport**. Në vlerësimin tonë mbetet me rëndësi që lëndët e profileve të mund të rishikohen duke u fokusuar më shumë drejt specifikave të profilit. Nuk vlen argumenti se numri i lëndëve është i kufizuar, pasi GVJ ka evidentuar lëndë që nuk kontribuojnë në formimin specifik të synuar.
3. Lidhur me komentin që bëhet për standartin II.4 Kriteri 7, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport**, pasi komenti i GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin, por vetëm jep arsyet se përse vlerësimi është ai i bërë nga GVJ.
4. Lidhur me komentin që bëhet për standartin III.3 Kriteri 4, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport**, pasi komenti i GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin, por vetëm jep arsyet se përse vlerësimi është ai i bërë nga GVJ.
5. Lidhur me komentin që bëhet për standartin IV.4 Kriteri 2, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi e njëjta problematikë kërkohet nga të dy standartet III.3 dhe IV.4, dhe GVJ do duhet të sqarojë dhe sugjerojë të dy standardet në të mirë të procesit.
6. Lidhur me komentin që bëhet për standartin IV.6 Kriteri 2, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport**, pasi komenti i GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin, por vetëm jep arsyet se përse vlerësimi është ai i bërë nga GVJ.
7. Lidhur me komentin që bëhet për standartin VI.2 Kriteri 3 dhe Kriteri 5, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport**, pasi janë sygjerime kryesore që GVJ i qëndron fort në përmirësim të programit të studimit. GVJ nuk ka kërkuar në asnjë moment të dhëna sensitive, por vendime të njësive të UET lidhur me format apo formularët për të cilët është diskutuar gjatë intervistës në institucion, për të qenë sa më argumentues në raport.


Së fundi vlen të theksojmë se disa prej dokumentave të ofruar nga UET, janë marrë parasysh si pjesë e dokumentacionit themelor të institucionit, edhe pse në disa raste nuk ka patur shoqërim me vendime, dokumenta me firmë apo vulë të institucionit. Bazuar dhe në intervistat në institucion GVJ ka bashkëvepruar për të ndërtuar një raport sa më realist dhe ndihmues për institucionin.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:


“Marketing”, me profile, “Turizëm”, “Inovacion”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh”, “TV Multimedia”, “Marrëdhënie Publike Politike”

I. OFRIMII PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien	UET është përshtatur me zhvillimet ekonomike të vendit si edhe me zhvillimet më të gjera në ekonomitë dhe shoqëritë



ndesh me interesat kombëtare.	<p>globale për ndërtimin e programeve formuese të Ciklit të Dytë të studimit Master Profesional në “Marketing” me profile: 1. Turizëm; 2. Inovacion; 3. Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh; 4. TV Multimedia; 5. Marrëdhënie Publike Politike.</p> <p>UET synon formimin cilësor të ekspertëve dhe specialistëve si në aspektet teorike po aq edhe në aftësitë praktike, aplikative në fushën e Marketingut në pershtatje me zhvillimet kombëtare dhe bashkëkohore. Dinxhitalizimi dhe Inovacioni po revolucionizojnë tregun dhe janë forcat me të cilat duhen përshtatur dijet e dhëna në këtë program. Gjithnjë e më shumë biznese dhe institucione në vendin tonë po kërkojnë specialistë në fushën e marketingut, për të mbështetur funksionet e tyre dhe realizuar aktivitetin në treg. Kësaj prirje i përgjigjet UET në ndërtimin e programit të studimit marketing me pesë profile, specializimi në fushat e interesit bazuar në kërkuesat e bizneseve dhe aktorëve të tjerë publikë e privatë. UET bën përpjekje të ofrojë një edukim cilësor që reflekton arritjet më të mira të shkencës, në fushën përkatëse të studimit.</p> <p>Ky master u siguron studentëve njohuri e praktikë në fushën e marketingut me qëllim përgatitjen e specialistëve të aftë për të marketuar veprimtari private e publike. Njohuritë marketing sot janë kthyer në domosdoshmëri për të gjitha institucionet private dhe ato shtetërore dhe ky master përputhet me kërkuesat aktuale kombëtare për ekspertë dhe specialistë të formuar në nivel cilësor në marketing. Nga diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të UET u dallua se programi MP Marketing me pesë profilet përbën risi në ofertën akademike dhe është në përputhje me kërkuesat nga tregu kombëtar i punës.</p> <p>(Ref – Dok 2. Statuti i UET, Dok 3.1 Strategjia e Kërkimit shkencor)</p>
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Vizioni i UET e angazhon atë në krijimin e një universiteti lider në zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare dhe në një qendër ekspertize në studimet shoqërore dhe ekonomike. Në këtë kontekst vetë institucioni mbështet programin e studimit MP Marketing, me procese cilësore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me qëllim sigurimin e dijeve të qëndrueshme e bashkëkohore teorike e praktike, të cilat janë evidentuar edhe tek qëllimi i programit të studimit dhe bazuar në dokumenta strategjike të insitucionit. Këto të fundit shtojnë vlerë akademike e kulturore në krijimin e traditës së arsimimit në këtë degë e fushë të dijes, e cila pas viteve '90 ka marrë vëmendje të rëndësishme për shoqërinë dhe ekonominë e vendit. UET me programin MP Marketing kërkon të



	<p>përforcojë njojuritë dhe ekspertizën në fushën e marketingut duke u mbështetur në bashkëpunimet me institucionet private, publike, organizatat e shoqërisë civile si dhe me aktorë lokalë për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, studimeve dhe kërkimeve në funksion të zhvillimit kombëtar. Qëllimi final është partneriteti drejt kërkimeve shkencore dhe të mësuarit më cilësor, i cili shprehet dhe në strategjinë e institucionit. Këto ndikojnë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë në sistemin e mësimdhënies dhe përvetësimin e dijeve dhe ruajtjen e forcimin e mëtejshëm të vlerave akademike e kulturore të kombit.</p> <p>(Ref –Dok 2. Statuti i UET Dok 3.1 Strategja e Kërkimit shkencor)</p>
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit “Master Profesional” në “Marketing me profile”, është në përputhje me misionin e përgjithshëm të UET për tu siguruar studentëve një edukim cilësor dhe dije të qëndrueshme përmes kërkimit shkencor për ndërtimin e shoqërisë së të ardhmes bazuar në dije. Tek misioni i tij vihet theksi tek elementi i cilësisë së edukimit, shërbimi i shoqërisë përmes dijes, konktributit në kërkim dhe përdorimit të tyre në të mirë të shkencës dhe tregut të punës. Në këtë kontekst duke krahasuar me elementët e programit MP Marketing, synon përgatitjen e specialistëve të kualifikuar për punësim e karrierë nësektorin publik dhe privat në fushën e marketingut sipas profileve, duke siguruar një arsimim të nivelit të lartë profesional, më dije bashkëkohore për menaxhimin e marketingut, si dhe me njojuri të qëndrueshme në fushatë përafërtë, duke ndikuar kështu në zhvillimin e kapaciteteve të marketingut të të gjitha niveleve. Programi i studimit Master Profesional Marketing me profile, është në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UET, dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë.</p> <p>(Ref – Dok 2. Statuti i UET)</p> <p>(Ref – Dok 5Rregullore UET)</p>
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>Synimi i programit të studimit MP Marketing me profile është të formojë profesionistë në fushën e marketingut, të cilët të kenë njojuri praktike për të zhvilluar strategji konkuruese të marketingut, për të krijuar vlera tek konsumatorët dhe nxitur zhvillimin ekonomik e social kombëtar. Aktualisht ky program studimi vjen si një përmirësim i programit të mëparshëm duke u bazuar në përshtatjen me nevojat e tregut. Keshtu, janë integruar në program aftësimi mbi strategjitet e marketingut të orientuara nga konsumatori, tendencat e reja përdorimin me</p>

	efikasitet të teknikave dhe metodologjive të kërkimit marketing, aftësimi lidhur me inovacionin e dixhitalizimin, dhe menaxhimin e reklames dhe komunikimet ne marketing. Nga takimet e zhvilluara në institucion dhe evidencat e numrit të studenteve të regjistruar në këtë program, vihet re se MP Marketing është një drejtim i kërkuar nga tregu i punës vendas, i cili po i shton vlerë arsimit profesional në vend përmes njojurive bashkëkohore dhe ndërkombëtare të ndërlidhura me përvojën shqiptare në funksionimin dhe menaxhimin e strukturave të specializuara në fushën e marketingut, të biznesit dhe të ekonomisë, në analizën dhe funksionimin e tregjeve specifike, të psikologjisë së marketingut dhe tendencave në marketing.
	(Ref- Rregullore MP Marketing)
	(Ref- Kurrikula e programit MP Marketing)

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushjet përshtatse	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit Master Profesional në Marketing me profilet përkatëse përshtatet me strategjinë e zhvillimit të UET, e cila përmban arritjen e ekselencës në aktivitete akademike e kërkimore, sigurimi i një cilësie të lartë në procesin akademik, pajisja e studentëve me njojuri e aftësi praktike duke integruar mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe krijimin e një mjeti nxitës dhe zhvillues drejt edukimit më të mirë. Përbajtja e programit MP Marketing e identifikuar qartë në syllabuse, ndërtimin e procesit mësimor, mënyrën e vlerësimit të studentit, përzgjedhjen e literaturës, etj. garanton zbatimin e strategjisë për zhvillimin e institucionit. Pas shqyrtimit te planit strategjik të UET në periudhën 5 vjecare 2015-2020, GVJ vuri re se priorititetet strategjike janë kërkimi shkencor, cilësia dhe përforma akademike, dhe bashkepunimet brenda dhe jashtë vendit, të cilat krijojnë një mjesdis që promovon të mësuarin e angazhuar, interaktiv duke i shërbyer edhe dialogut konstruktiv në nivel institucioni. Pjese e ketyre prioriteteve eshte përshtatja e vazhdueshme e kurrikulave dhe



	<p>programeve me tregun e punës. Ndaj vlen të theksohet se rishikimi dhe riorganizimi i programit të studimit MP në Marketing me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 664, datë 12.10.2018 me 60 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master Profesional" në "Marketing", me profile, "Turizëm", "Inovacion", "Menaxhim" dhe Vlerësim Projektesh", "TV Multimedia", "Marrëdhënie Publike Politike", është në përputhje me strategjinë e institucionit për sigurimin e shumëlojshmërisë së profileve të formimit, përshtatjen e metodave dhe e niveleve të financimit për to dhe zgjerimin horizontal në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit.</p> <p>(Ref – Dok 2 Statuti UET), (Dok 7 Rregullore e programit të studimit MP "Marketing" me profile)</p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Programi MP Marketing me profile është në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit në fuqi, duke ofruar një tërësi prej 9 lëndësh/disiplinash ku përfshihet edhe praktika mësimore dhe Punimi i diplomës/Provimi i formimit, me një total prej 60 kreditesh. Këto elementë janë konceptuar për të garantuar rezultate akademike në diplomimin e profesionistëve të aftë për të punuar në fushat e përgjedhura ndërdisiplonore. Në këtë kuadër, programi i studimit është bazuar në statutin, misionin dhe vizionin e UET. Drejtim prioritari i institucionit eshte rritja e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore.</p> <p>Në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të UET gjemë të përcaktuar mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegiale dhe administrative si dhe të autoriteteve drejtuese të institucionit, të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Synimi i UET ka qenë hartimi i programit të studimit MP Marketing me profile në koherencë me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësive kryesore dhe integrimin e ndërdisiplonor brenda një programi për të rritur eficencën institucionale. Statuti është dokumenti kryesor, prej të cilit hartohen rregulloret dhe procedurat, e Fakulteteve dhe Departamenteve dhe organeve të tjera mbi bazen e të cilave zhvillohet e gjithë veprimitaria mësimore, shkencore dhe edukative në UET</p>

	<p>(Ref – Dok 2. Statuti i UET)</p> <p>(Ref – Dok 5 Rregullore UET)</p>								
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	<p>Programi emërtohet Master Profesional në Marketing dhe është i degëzuar në pesë profile: Turizëm, Inovacion, Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh, TV dhe Multimedia dhe Marrëdhënie Publike Politike. Ky program ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në UET. Ky program ofrohet në shumë profile dhe ka aplikim ndërdisiplonor. Përkatësisht brenda një kurrikule studimi ka ndërthurje të disiplinës marketing me disiplina të tjera. Programi i studimit lidhur me emërtimin organizimin dhe strukturën është në përputhje me drejtimin akademik të institucionit në fushën e Ekonomisë dhe biznesit, si pjesë e këtij fakulteti.</p> <p>(Ref – Dok 2. Statuti i UET)</p>								
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitet kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	<p>UET ka hartuar planin strategjik 5 vjecar “2015-2020” pjesë e të cilit është dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. UET përpinqet të mbajë një ekuilibër mes gjërisës dhe thellësisë së studimeve, fleksibilitet kurrikular dhe lehtësim të zgjedhjes/përcaktimit të fushës së studimit nga studentët. Përmes programit MP Marketing UET promovon disa vlera themelore si lidership, cilësi dhe punë grapi, liri eksplorimi intelektual, drejtësi dhe integritet, transparencë dhe përgjegjshmëri si dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Ky përputhet me kërkesën aktuale për ekspertë dhe specialistë të formuar në nivel cilësor në marketing në rang kombëtar e ndërkombëtar.</p> <p>Ref – Dok 3 Plani strategjik 2020</p>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk mbushjet</th> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td></td><td style="text-align: center;">X</td></tr> </tbody> </table>	Nuk mbushjet	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht				X
Nuk mbushjet	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht						
			X						

Standardi I.3

Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto	Sipas Rregullores së Programit të studimit pika 3.3, janë përcaktuar objektivat per formimin e studenteve. Në qendër të programit të studimit MP Marketing është studenti, në



<p>programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>aspektin e mësimdhënies/mësimnxënies si edhe në daljen e tij në tregun e punës në një drejtim të ngushtë sipas profilit të zgjedhur. Kompetencat profesionale të studentit në dalje lidhen me profilin e përzgjedhur. Në përfundim të programit MP Marketing studentët kanë mundësinë të zhvillojnë aftësitë praktike përmes një praktike të zgjeruar në korporatat e bizneset kryesore dhe integrim në tregun e punës. Gjithashtu, studentët zhvillojnë një diplomë të karakterit praktik, aplikativ, në formën e një studimi. Sipas diskutimeve nga afér me përfaqësues të UET u theksua se programi profesional në Marketing është riorganizuar në 1 vit me qëllim trainimin dhe përgatitjen e shpejtë të studentëve për tregun e punës. Rezulton se nga ana e UET është realizuar analiza e nevojave të tregut për zhvillimin e këtij programi përmes bordeve të tregut të punës dhe ish studentëve në karrierë –Alumni.</p> <p><i>(Ref- Rregullore MP Marketing)</i></p> <p><i>(Ref- Kurrikula e programit MP Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpëra hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitet e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Sikurse u evidentua me sipër UET ka bërë përpjekje për të analizuar nevojat e tregut të punës në përputhje me programin e studimit MP Marketing. Për këtë janë realizuar studime nga zyra e Karrierës me synim gjurmimin e studentëve të diplomuar (Alumni) në tregun e punës, duke evidentuar profilet dhe punësimin e tyre, takime me Bordet e Tregut të punës, dhe studimi PERFORM, ku UET ka organizuar takime me grupe ekspertësh, në lidhje me atë që universitetet ofrojnë dhe tregjet e punës kërkojnë. Vlerë e shtuar për gjurmimin real të studentëve janë dhe evenetet e organizuara si Festivali Alumni dhe Open Œeks-panairi i punës i çdo fakulteti të UET. Zyra e Karrieres ka një bazë të dhëash të pasur për studentët, kujdeset të gjurmojë me rigorozitet dhe në mënyrë periodike punësimin real të studentëve të diplomuar dhe ndjek zhvillimet e në sektorin përkatës përmes marrëveshjeve të ngushta në tregun e punës (vizita në institucion).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës garantojnë përfthimin e dijeve, aftësive, shkaktësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë</p>	<p>Objektivat dhe struktura e programit të studimit MP në Marketing janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Lidhur me përbajtjen e programit të studimit, përbëhet nga (1) lëndë e formimit të përgjithshëm, (3) lëndë të formimit karakterizues (3) lëndë me zgjedhje të grupuara sipas pesë profileve, lënda Praktikë dhe Zhvillim karriere dhe Diploma.</p>



punësimin e studentëve.	<p><i>Lidhur me lëndët me zgjedhje të secilit profil, GVJ konstatoi se lëndët e profilit në disa raste nuk lejojnë një specializim të thelluar të studentit në profilin përkatës, pasi nuk garantojnë përfshimin e dijeve dhe kompetencave specifike te profilit dhe nuk përputhen me nevojat e tij. Për shembull, përfshimi i dijeve, aftësive, shkathësive të fituara në profilin turizëm kufizohen në aspekte të komunikimit përmes lëndëve Marketingu digital dhe media sociale dhe Komunikimi marketing i integruar dhe nuk ofrojnë dije specifike të turizmit. Po ashtu në profilin Inovacion nuk ofrohen dije specifike të profilit përmes lëndës Marketing Ndërkombëtar. Këtu GVJsugjeron një rishikim të lëndëve me zgjedhje, veçanërisht në profilet e sipërpërmendura.</i></p>
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucionë ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	<p>Programi i studimit MP Marketing me profile nuk haset rendom nga IAL-të publike në vend dhe IAL ndërkombëtare. Megjithatë nga shqyrtimi i syllabuseve vihet re se përbajtja e lëndëve është e ngjashme me lëndët në programe analoge dhe ndaj lehtëson transferime studimeve në program master marketing, mobilitetin e studentëve dhe punësimin e tyre në tregun ndërkombëtar. Në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit MP Marketing pika 9 “Transferimet”, sqaron vetem procedurën e transferimit të studimeve nga një universitet tjeter në UET dhe jo anasjelltas, duke krijuar paqartësi për këto raste.</p> <p><i>Shtimi i pikave edhe për këto raste sygjerohet nga GVJ.</i></p>
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.	<p>Nga shqyrtimi i akteve të vëna në dispozicion nga Institucioni konstatohet se Syllabuset janë përditësuar sipas modelit që është pjesë e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë” Cdo program ka të pasqyruar përbajtjen e detajuar dhe është vlerësuar në kredite spas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Diplomat që jepet në përfundim të programit të studimit Master shoqërohet me suplementin e diplomës.</p> <p>Programi i studimit organizohet në përputhje me procesin e Bolonjës. Ai ofrohet me kohë të plotë dhe i shprehur në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo pasqyrohet ne Rregulloren dhe Statutin e UET. Programi i ciklit të dytë Master Profesional në Marketing është hartuar mbi bazën e standardeve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë në Udhëzimet e MAS si dhe direktivat e BE-së për arsimin e</p>



	lartë.								
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Nga shqyrtimi i rregullores së studimit GVJ konstatoi se është përcaktuar qartë organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale në këtë program studimi. Praktikat profesionale janë të mirë organizuara në përputhje me qëllimin dhe objektivat e planit të studimit. UET ka vënë në dispozicion të GVJ 15 marrëveshje bashkëpunimi me organizata publike e private për sigurimin e praktikave mësimore dhe zhvillim karriere të studentëve të programit master MP Marketing.								
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Programi MP Marketing zhvillohet në gjuhën shqipe. Përjashtim bëjnë rastet e lektoreve të ftuar dhe studentëve të ardhur me programin e shkëmbimit Erasmus+. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me faktin se në varësi të studentëve të huaj janë bërë përshtatje për ofrimin e mësimdhënies në gjuhën angleze për kategori lëndesh të vecanta. UET ka kapacitet për të ofruar module në gjuhën angleze në shkëmbimin e studentëve përmes programit Erasmus.								
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Ky kriter nuk aplikohet pasi Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional ‘Marketing’ me profile është ekzistues. Ai u licensua në fillim me VKM, Nr. 74, datë 21.01.2009, dhe u riorganizua me Urdhër të MAS, Nr. 664, datë 12.10.2018. Programi i studimit realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me kohë të plotë, me kohëzgjatje 1 vit akademik (2 semestra), dhe në përfundim lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Marketing”, me profile, “Turizëm”, “Inovacion”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh”, “TV Multimedia”, “Marrëdhënie Publike Politike”. Në vitin 2018, programi i është nënshtruar procesit të akreditimit periodik (Vendimi i BA, Nr. 31, datë 13.07.2018) por si pasojë e riorganizimit, po i nënshtronhet sërisht vlerësimi për vitin akademik 2018-2019.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjessërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjessërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjessërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni	UET ka përvojën dhe kapacitet në fushën akademike për




<p>demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>përbushjen e qëllimit të këtij institucioni dhe ofrimin e programit të studimit Master Profesional në Marketing. Ky Master ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë i cili nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik si edhe për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit. Në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të UET gjemë mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegjiale dhe administrative të institucionit. Hartimi i programit master me profile vë në eficencë burimet njerëzore të UET pasi integron stafin e departamenteve të tjera me qëllim ndërthurrjen e kompetencave për plotësimin e shumëlojshmërisë së profileve.</p> <p>Sipas evidencës (23. <i>Personeli akademik ne njesine kryesore dhe perqyegjese</i>), Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ka gjithsej 48 pedagogë, nga të cilët 35 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku 5 kanë titullin "Profesorë", 7 kanë titullin "Profesorë të Asociuar", 11 kanë gradën Dr./PhD, dhe 12 Asistent Lektorë me Msc; dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 2 kanë titullin "Profesorë të Asociuar", 5 kanë gradën Dr./PhD. dhe 6 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>UET ka pasur lëvizje të konsiderueshme të stafit akademik e titular vitin e fundit, por kjo nuk ka cënuar ofrimin e programit të studimit, ku në vitin 2018-2019 personali akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga 9 PAE dhe 2 PAK.</p> <p>Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit është 2 Prof.Dr, 3 Prof.Asoc dhe 4 Dr.</p> <p>Raporti PAE/PAK i stafit të angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2018-2019 rezulton 81% me 19%.</p> <p>Vihet re një rekrutim i vazhdueshem i stafit të ri, për të plotësuar pozicionet vakante në përputhje me profilet.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e</p>	<p>UET vepron brenda kornizave ligjore dhe respekton ligjin e Arsimit të Lartë në fuqi (L.80/2015 Neni 23 pika 1) dhe përcaktimet statutore. Strukturat janë të formuara që të garantojnë arritjen e misionit të UET në pëmbushje të autonominë akademike. Stafi akademik i UET ka konsoliduar strukturën e kërkimit shkencor dhe zhvilluar</p>



	<p>studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>objektivat e kërkimit në përputhje me fushën përkatëse të formimit të specifikuar dhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2017-2020.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me Stafin Akademik u pohua se personeli është nxitur të marrë pjesë në projekte kërkimore, konferanca e aktivitete të tjera shkencore, të publikojë rezultatet e punës kërkimore, duke përfituar edhe mbështetje financiare përmes akordimit të granteve kërkimore vjetore.</p> <p>Programi i Studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të vendosur nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>								
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut. Fusha kërkimore dhe akademike e kësaj njësie bazë rezulton të jetë në koherencë me programin e studimit sipas klasifikimit të këtij të fundit.</p>								
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantonhet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë Master Profesional në “Marketing me profile”, është tërësisht në drejtimin specifik brenda profilit të institucionit.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhëniet bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vizita në Institutin, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit MP Marketing me profile, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përbushur objektivat e programit dhe angazhuar staf të kualifikuar. Një pjesë e lëndëve/ moduleve bazë të programit mbulohen nga stafi i DMM, ndërsa angazhohet staf nga departamentet e tjera dhe fakulteteve të UET për lëndët me zgjedhje të profileve brenda kurrikulës. Programet në UET janë organizuar me profile që lejojnë bashkërendim të stafit ndër disiplina e profile formimi, ku dhe Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut angazhohet në programe studimi të njësive të tjera. I gjithë procesi për përbushjen e disciplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikqyret nga instancat drejtuese të UET duke filluar nga Zv. Rektori, Zv. Dekani, Pergjegjësi i Departamentit, Sekretaria, SBC etj. Në cdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës së njësive.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendllo marrëdhëniet bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe praktikave profesionale, UET ka marrëveshje me palët e treta, institacione e biznese për shkëmbim ekzpertize në funksion të procesit mësimor dhe realizimin të objektivave të programit të studimit. Një bashkëpunim të gjerë UET ka me aktorë biznesi brenda vendit, ku GVJ-së, i janë vënë në dispozicion 15 marrëveshjet e nënshkruara që u japid mundësi studentëve të kryejnë praktika profesionale në këto biznese. Gjithashtu UET ka krijuar disa marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet homologe edhe jashtë vendit përmes programit Erasmus+ me objekt shkëmbimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e programeve të reja të studimit.
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucionet, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	UET ka nënshkruar 15 marrëveshje me biznese dhe institucionet, që i vijnë në ndihmë studentëve të programit “Master Profesional Marketing me profile” për praktikat mësimore dhe zhvillim karriere. Qëllimi i praktikës profesionale në programin MP Marketing është i dyfishtë. Së pari që studenti të aplikojë njohuritë teorike në praktikë dhe të fitojë shkathtësi e kontakte në tregun e punës. Së dyti për zhvillimin e projekteve kërkimore me angazhimin e studentëve në kërkimin shkencor në përputhje me Strategjinë e Kërkimit Shkencor të UET. Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve pranë UET është angazhuar në grupe kërkimore për projekte me institucionet vendase e të huaja, ndërsa Zyra e Karrierës kujdeset për zgjerimin e bizneseve



	partnerë përmes Panairit të Punës në UET dhe siguron përtej praktikës mësimore, punësimin e studentëve.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimi të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	UET ka vendosur në dispozicion të GVJ një dokument me Institucionale/kompani në të cilat studentët e programit Master Profesional Marketing kanë zhvilluar praktikat e tyre. Studentët aktual dhe studentët e diplomuar të këtij programi janë ndërlidhës të institucionit me biznesin ku zhvillojnë praktikën apo janë të punësuar. Vlen të theksohet se një pjesë e studentëve që ndjekin MP Marketing janë të punësuar dhe praktikën e zhvillojnë në vendin e punës. Procesi mbikëqyret nga Zyra e Karrierës në bashkëpunim me departamentin dhe pedagogun mbikëqyrës të praktikës.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UET ofron trainime profesionale për studentët. Nga takimi me zyrën e Karrierës u evidentua se për këtë bashkëpunohet me punëdhënësit dhe evidentohen fushat specifike të trainimit dhe zhvillimit të karrierës. Ndërsa Zyra e Karrierës së UET është aktive si qëndër punësimi dhe zhvillimi karriere për studentët.			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Zyra e Karrierës së UET mban një bazë të dhënash të detajuar të studentëve dhe bizneseve. Kjo bazë të dhënash përkon me dosjen e praktikës së studentit e cila është një relacion në formën e raportit të praktikës me tre çështje kryesore; Informacione të përgjithshme lidhur me kompaninë ku kanë kryer praktikën, detyrat dhe projektet konkrete me të cilat janë angazhuar, si dhe një reflektim lidhur me kontributin e programit specifik të studimit në eksperiencën e tyre praktike. Zyra e Karrierës bën vlerësimë dhe analiza periodike të praktikave në institucione publike me private. Gjithashtu, nga vizita në institucion, departamenti çdo vit bën analizën e punës mësimore dhe konstaton marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera në përfitimet konkrete në funksion të realizimit të programit mësimor.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



**ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT
TË CIKLIT TË EDYTYË MASTER PROFESIONAL**

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organzuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni konfirmohet që programi i studimit Master profesional “Marketing me profile” organizohet sipas ligjit, në lëndë e module ku secila vlerësohet me kredite sipas sistemit ECTS. Në këtë kontekst programi është në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke ofruar një tërësi prej 4 lëndë/module të detyrueshme, 3lëndëme zgjedhje si edhe praktikën mësimore, dhe punimin/provimin e diplomës, me një total prej 60 kreditesh.</p> <p>Bazuar mbi dokumentacionin për hapjen e programit të studimit, dokumentat e programit mësimor dhe planit mësimor, dhe rregullore e programit të studimeve, ka një shpërndarje sipas ligjit e moduleve dhe e krediteve, gjithashtu duke parashikuar sipas standardeve orët fizike, orët në auditor (leksione, seminare, praktika mësimore) dhe ato të studimit individual, orë për praktikat në terren apo përgatitjen e temës së diplomëskanjë ndarje të qartë sipas ligjit e moduleve konkretisht:</p> <p>Lëndë bazë 6 kredite;</p> <p>Lëndë karakterizuese 18 kredite;</p> <p>Lëndë ndërdisiplinore dhe integruese 18 kredite;</p> <p>Lëdnë plotësuese 6 kredite;</p> <p>Detyrime përmbyllëse, tema e diplomës, 12 kredite;</p> <p>(<i>Evidenca 14 Kurrikula MP Marketing ku është Programi i riorganizuar 2018-2019 dhe Evidenca 14.1 plani mësimor i programit MP Marketing</i>).</p> <p>Në (<i>evidencën 7 Rregullore e programit të studimit</i>), paraqitet shpërndarja e lëndëve sipas legjislacionit në fuqi në pikën 3.1 struktura e programit mësimor.</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjërë profesionesh e	<p>Duke iu referuar programit të studimit, përshkrimi të detajuar tëlëndëve, mund të thuhet se ka një shpërndarje të duhur të dhënes së njohurive për të krijuar specialistët e duhur në fushën e marketingut. Llojshmëria e profilevebrenda kësaj diplome mbështetet nga llojshmëria e fushave të zgjedhura</p>



specialitetesh.	<p>brenda menaxhimit të marketingut.</p> <p>(<i>Evidenca 7 – rregullore e programit të studimit</i>) paraqet në pikën 3.3 qëllimin dhe objektivat e programit të studimit, ku përfshihen synimet për të nxjerrë profesionistë të përgatitur përmes aspekteve teorike dhe praktike (<i>pika 3.3.2 a-h</i>). Gjithashtu fakti që ka disa profile të ndërtuara mbi lëndët/modulet me zgjedhje u jep mundësi studentëve të specializohen dhe programit të ofrojë një llojshmëri të gjërë profesionesh e specialitetesh.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të dytë japidin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Një aspekt tepër i rëndësishëm dhe themelor në vlerësimin e efektivitetit të çdo program studimi është mënyra se si ai formon studentët në të menduarin kritik dhe vlerën që ka si në aspektin teorik dhe atë praktik. Duke iu referuar syllabuseve të detajuara, konkretisht rubrikës “Përbledhja dhe qëllimet e kursit” dhe “koncepte themelore çelës”, ku referohen tematikat e fushës përkatëse të studimit, qëllimet lidhur me aftësitë e kompetencat të cilat do të duhet të fitojë studenti duke përfshirë analiza teorike e praktike dhe qasje kritike të njohurive. Në program janë të përfshira lëndë të rëndësishme të formimit bazë dhe karakterizue, siç janë: “Metodat e kërkimit të avancuara”, “Kërkimi marketing”, “Marketingu i shërbimeve” dhe “Marketing strategjik”, të cilat janë baza e formimit teorik dhe parimeve akademike të menaxherit të marketingut.</p> <p><i>Por lidhur me lëndën bazë GVJ vë re se lënda bazë “Metoda Kërkimi të Avancuara” nuk përbën nevojë në një program të Masterit Profesional, ku lëndë bazë shumë mirë mund të konceptohen lëndët e lidhura me Menaxhmin strategjik të marketingut dhe planifikimin qoftë edhe e lidhur me kërkimin e apikuar në treg (në formë moduli). Metodat e kërkimit të avancuar është lëndë që i shërbën formimit në një master shkencor.</i></p> <p>Gjithashtu vizitat në terren, specifikisht intervistat me pedagogët treguan dhe identifikuat metodat e përdorura prej tyre gjatë procesit të mësimdhënieς, ku përdorimi i ndërveprimit, komunikimit dhe dialogut, ndikon në formimin e të kuptuarit dhe të menduarit kritik mbi njohuritë e marra. Intervista me studentët do të duhej ta përforconte këtë aspekt, por nuk u arrit një sesion i plotë në intervistën me studentët, për të patur mundësi të merrej ky feedback edhe prej tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe</p>	<p>Programi i Master Profesional në Marketing me profile, siç u argumentua edhe më lart synon të krijojë tek studentët disa kompetenca të avancuara sidomos përmes profilizimit. Ky fakt</p>



<p>kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>u diskutua gjithashtu gjatë vizitave në terren, në intervistat me dekanin dhe përgjegjësin e e departamentit. Më tej, duke analizuar secilin prej syllabuseve të lëndëvemund të konkludohet se njojuritë, aftësitë dhe kompetencat e avancuara dhe zgjidhja e problemeve komplekse janë elementë të evidentuar në <i>temat e programit për secilën lëndë, por sidomos edhe në literaturat e propozuara</i> të cilat evidentohet të janë bashkëkohore. Disa nga fushat e specializuara si Inovacion, Menaxhim dhe vlerësim projektesh dhe TV multimedia, marrëdhënie publike politike, përfaqësojnëme lëndët përkatëse aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas fushave të specializuara.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të dytë përbajnjë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Struktura e programit Master profesional në Marketingështë në përputhje të plotë me Ligjin e arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, duke përfshirë një tërësi lëndësh formuese dhe specializuese për studentët. Gjithashtu programi është saktësisht i shpërndarë me ngarkesat përkatëse sipas formave të zhvillimit të njojurive, leksione, seminare, laboratore, praktika mësimore, temë diplome. Evidentimi është i qartë përmes planit të detajuar dhe rregullores së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, duke u bazuar edhe në Vendimin nr 41, dt 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” specifikisht pikat 3 dhe 4 paraqiten, grupet e klasifikimit të veprimtarive formuese dhe disiplinave të programit, të pasqyruara në programin e studimit dhe kreditet përkatëse.</p> <p>Ky klasifikim përfshin modulet e disiplinave të formimit të përgjithshëm, karakterizuese, të ngjashme me ato karakterizuese, modulet e disiplinave me zgjedhje dhe ato të gjuhës së huaj e praktikave, sipas VKM të sipërcituar. Përshtatja e moduleve me kategoritë paraqitet edhe përmes programeve, përbajtjes, synimeve e objektivave, temave, krediteve, element të cilët janë shpjegues për përfshirjen e secilit modul në kategorinë përkatëse.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimese në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat</p>	<p>Praktika dhe Zhvillim karriere në programin e Masterit Profesional në Marketing me profileështë vendosur në grupin e lëndëve plotësuese me 10% të krediteve, konkretisht me 6 kredite dhe është organizuar në 4 javë janë në auditor dhe 3 javë në Institucion/Kompaninë ku është bërë marrëveshja që studentëtëndjekin praktikën. Sipas (<i>evidencës 7 kërkesat për praktikën dhe zhvillimin e karrierës</i>) janë të vendosura në pikën 7 të rregullores dhe gjithashtu ka edhe një rregullore të</p>



evropiane.	vecantë për praktikën që tregon për ndjekjen dhe mënyrën e përbushjes së detyrimeve të studentit lidhur me praktikën, mbrojtjen e praktikës përpara një komisioni të vecantë, etj. (evidence 32.1 - dokumenti mbi praktikën profesionale).			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushjet përmes përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht	X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore përvlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimitpranë UETështë njësia kryesore, e strukturuar për të ofruar programe studimi në tre ciklet, bachelor, master, doktoraturë, në përputhje me llojin e institucionit të arsimit të lartë dhe bazuar mbi Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". Bazuar në evidencën e Statutit dhe rregullores së UET, si edhe bazuar mbi kërkesat ligjore, pranohet se njësia kryesore – fakulteti përbush detyrimet ligjore përkatëse. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut lëshon diplomën e Ciklit të Dytë Master profesional "Marketing me profile".</p> <p>Sipas Statutit të UET, Departamenti është njësia bazë përgjegjëse për realizimin e programeve të studimit, duke realizuar të gjitha detyrat dhe mbajtur përgjegjësitëbazuar mbi Ligjin e Arsimit të Lartë.</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Siapas <i>Evidences 6 (Organizimi dhe funksionimi i dekanatit dhe departamentit)</i> paraqiten të gjitha kushtet e organizimit dhe strukturës që lidh departamentin dhe fakultetin, detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve dhe organeve të tyre drejtuese, të cilat janë në përputhje me legjisacionin në fuqi, aktet ligjore dhe nënligjore. Departamenti i Menaxhimit dhe marketingut organizohet në grupe mësimore, ku janë përcaktuar përgjegjësit e grupeve mësimore. Ai është pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit dhe organizohet si pjesë e tij. Funksionet e departamentit përcaktohen në tri sfera, mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe veprimtaritë administrative. Seksioni F V.2 jep organizimin e departamentit, seksioni F V. 4., paraqet detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të departamentit, ndërsa seksioni F V.5 jep përgjegjësitë e përgjegjësit të grupit

	<p>mësimor.</p> <p>Fakultetii Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimitështë i përbërë nga tre departamente konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dep i Ekonomksit dhe Financës, i cili ka; 18 PAE, nga ku 11 grada/tituj; 2. Dep i Menaxhimit dhe Marketingut, i cili ka 9PAE ,nga ku 8 grada/tituj; 3. Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm, e cila ka 8 PAE, nga ku 4 grada/tituj;
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	<p>Departamenti si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Marketing me profile gjithashtu përbush kushtet ligjore lidhur me stafin akademik. Për vitin akademik 2018-2019, departamenti ka në përbërje gjithsej 16 personel akademik, nga ku 9 Personel Akademik Efektiv(PAE), ndër të cilët 2 me titullin Prof.Dr, 2 me titullin Profesor i Asociuar, 4 me gradën Doktor dhe 1 me Msc, dhe 7 personel akademik me kontratë(PAK), nga ku 4 me grada/tituj. (<i>evidence 23, personeli akademik në njësinë kryesore dhe njësinë bazë</i>).</p> <p>Vërejmëse sipas RVB ky numër nuk është i saktë bazuar në evidencën 23.</p> <p>Për nga numri dhe kualifikimet e stafit akademik, ndërtimi i strukturave dhe zbatueshmëria e ligjit dhe akteve nënligjore, Diploma e ciklit të Dytë Master profesional në Marketing përbush plotësisht detyrimet ligjore.</p>
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia kryesore dhe njësia bazë përbushin të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	<p>Departamenti, si njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përcakton një përgjegjes të praktikave për departamentin (<i>evidence 32.1 pika B.I.7.3</i>).</p> <p>Gjithashtu, përgjatë përshkrimit të procesit në pikën B.I. 7.5 përcaktohet roli dhe detyrat e përgjegjësit/korrodonatorit të praktikës. Nuk thuhet se ky është personel akademik ndihmës, por gjithsesi edhe si pjesë e personelit akademik ka përgjegjësinë e ndjekjes së praktikave të studentëve sipas rregullores së praktikave.</p>



Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për securinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Bazuar mbi evidencën 36 (Vendimi për emërimin e koordinatorëve të programit të studimit), Faulteti i Ekonomisëbiznesit dhe zhvillimit me vendim nr. 93 datë 03.12.2018, ka përcaktuar një koordinator për çdo program studimi dhe përkatësisht Prof. Asoc. Kreshnik Bello, për programin MP në Marketing me profile. Aneksi bashkëlidhur këtij vendimi përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit.			
Kriteri 7. Koordinatori i programitraporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Aktualisht bazuar mbi evidencën 36 (<i>Vendimi per emerimin e koordinatorit te programit</i>), janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit, i cili është përgjegjës për securinë e zhvillimit të kurrikulës, shqyrton hartimin e syllabuseve të lëndëve, sigurohet për ndryshimet në përputhje me standartet e vendosura, është përgjegjës për tezat e provimeve, apo mbarëvajtjen e praktikave mësimore, përditimin e bazës së të dhënavë me marrëveshjet përkatëse dhe së fundi harton një raport në mënyrë periodike cdo vit, mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Nëse do të bazohemi tek evidencat, e formateve tezave të provimit të diplomës, syllabuseve, praktikave, firma e përgjegjësit të grup lëndëve, si koordinator i programit mund të themi se roli i tij përbushet.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Një përbushet <input type="checkbox"/>	Përbushet pjessërisht <input type="checkbox"/>	Përbushet kryesisht <input type="checkbox"/>	Përbushet plotësisht <input checked="" type="checkbox"/> X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.	Organizimi, struktura dhe përbajtja e programit të studimit ndërtohen bazuar në gjithë informacionin mbi programin e studimit, stafin akademik dhe strukturat e njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Linja e informacionit lëviz sipas hierarkisë, duke marrë si input dokumentat kryesore në nivel Institucional, ku përfshihen, ligje, vendime, udhëzime rregullore, statuti, të cilat vijnë të protokolluara dhe sipas

	<p>afateve nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, miraton rregulloret përkatëse dhe përcjell informacionin mbi vendimet dhe vleësimet në të dy drejtimet. (<i>Evidenca 2 Statuti UET dhe evidence 5 Rregullorja UET</i>). Gjithashtu Departamenti disponon informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e programit të studimit, lidhur me marrëdhëniet me studentët, të shprehura në statut, rregullore si dhe bazuar mbi rregulloren e programit të studimit (<i>evidence 7</i>).</p>
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Bazuar mbi synimet dhe objektivat e programit të studimit, të cilat paraqiten në evidencën 7 (pika 3.3), i jepet rëndësi formimit të duhur sipas lëndëve të kategorizuara sipas legjislacionit në fuqi, por edhe profileve që bazohen në ndërtimin e kapaciteteve praktike të studentëve në fusha specifike të marketingut. Ky program ka ndërtuar edhe përbajtjen e tij duke klasifikuar modulet apo lëndët në aktivitete formuese dhe aktivitete praktike. Praktikave mësimore iu është dhënë ngarkesa e parashikuar ligjore prej 6 krediteose 10% e gjithë programit prej 60 kreditesh, duke i lejuar studentët që semestrin e fundit të realizojnë aktivitetin e praktikës mësimore, por nga ana tjetër edhe në cdo modul mund të evidentohet përmes syllabusit se i lihet një hapësirë pjesës praktike lidhur me projektet konkrete të kursit, rastet studimore nga praktika sidomos shqiptare, por edhe e huaj. Raporti i moduleve e aktiviteteve formuese si edhe atyre praktike është në përputhje me bazën ligjore në fuqi, vendimet dhe udhëzimet. (Evidenca 14 kurrikula e programit, evidenceshtesëe planit mësimor të detajuar.)
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	<p>Programi i studimit Mp në Marketing me profile, bazohet në sistemin e vlerësimit me kredite ECTS, sistem i cili është pranuar gjerësisht në nivel European dhe në nivel kombëtar, duke krijuar mundësinë e krahasimit të ngarkesës së nevojshme për realizimin e një programi studimit dhe secilës lëndë.</p> <p>Numri prej 6 krediteve për secilën lëndë, dhe bazuar mbi përqindjet për secilin grup/kategori lëndësh duke u bazuar tek lloji i disiplinës, paraqet gjithashtu një kornizë të krahasimit të moduleve dhe i krijon mundësinë studentit të kuptojë ngarkesën dhe punën e tij semestrale dhe vjetore. Ai gjithashtu pasqyron kritere për kalimin e të gjitha provimeve dhe performancën e studentit në vitin akademik, duke kaluar në një vit pasardhës apo duke përfunduar studimet.</p> <p>(Evidence 7 Rregullore e programit të studimit)</p>

	<p>Konkrehtisht ndarja në semestra është sipas një balancimi, ku lëndët bazë 6 kredite, 2 lëndëkarakterizuese, 12 kredite së bashku me një prej disiplinave me zgjedhje, (6 kredite) dhe një pjesë e punimit të diplomës, 6 kredite, gjithsej 30 kredite janë shpërndarë në semestrin e parë. Pjesa tjeter, një lëndë karakterizuese, dy lëndë me zgjedhje (të profilit përkatës), praktika dhe punimi i diplomës, gjithsej 30 kredite, janë shpërndarë në semestrin e dytë. Pra, viti akademik përbëhet nga dy semestra, ku janë shpërndarë në mënyrë të balancuar, ngarkesa e krediteve të lëndëve në cdo semestr. Lëndët dhe shpërndarja e tyre me kreditet, orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, që zënë modulet e kategorive të ndryshme janë në zbatim të vendimit nr 41 dt 24.01.2018, udhëzimeve të MASR dhe rregulloreve të institucionit dhe programit.</p> <p>Dokumentat ku mund të verifikohet ndarja sipas krediteve dhe ngarkesave janë:</p> <p>(Evidencia 14 kurrikula mësimore)</p> <p>(Evidencia e planit mësimor të detajuar)</p>
Kriteri 4. Programet e studimit përbajnjë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<p>Kurrikula dhe plani mësimor janë dokumente themelore që shoqërojnë programin e studimit Master profesional në Marketing me profile. Plani mësimor hartohet nga departamenti bazuar mbi kurrikulën dhe miratohet nga dekani.</p> <p><i>Ai përfshin informacionin mbi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Raportin e orëve të leksionit dhe seminarit përfaqësuar me kreditet dhe orët e punës në auditor dhe të pavarur. Një kredit është një orë mësimore punë e studentit përbërë nga orët në auditor dhe jashtë tij; - format e mësimdhënies dhe orët totale në auditor; - mënyrën e përcaktimit të krediteve; <p>Rregullorja e programit paraqet frekuentimin/ndjekjen dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, përkatësisht në pikën 6 dhe pikën 5.</p>
Kriteri 5. Programet e studimit përbajnjë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Informacionet për studentët lidhur me programin e studimit janën të paraqitura në ëeb-site të UET dhe jepen në rregulloren e programit. Kriteret e pranimit të studentëve informacion mbi transferimet, ndërprerjen e studimeve apo se si ekuivalentohen studimet (Pika 2, pika 5, pika 9). Sa i përket pranimeve, transferimeve dhe ekuivalentimit sqarohet në rregullore me qartësi se cilat procedura do të duhet të ndjekë student, cilat janë rastet përjashtimore, si do të ekuivalentohen programet dhe vlerësohet performance</p>




	nëinstitucionin nga vjen. Gjithashtu dokumentat strategjikë statute dhe strategjia e UET japid informacionin e përgjithshëm mbi studentët duke i udhëzuar ata përgjatë periudhës së studimeve.								
Kriteri 6. Programet e studimit përbajnjë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuarë.	Programi i studimit Mp në Marketing me profile, përbëhet nga lëndë, secila me syllabusin e vet, që ka një strukturë të quartëdhe përmban informacionin e domosdoshëm për studentin që të ndjekë me sukses kursin e lëndës gjatë semestrit/vitit. Programet e lëndëve i formojnë studentët në fushën e përgjithshme të marketingut dhe më tej sipas profileve të caktuara. Syllabuset përbajnjë informacionin e detajuar mbi emërtimin e lëndës, vitin dhe semestrin kur do të zhvillohet lënda, ngarkesën, emrin e pedagogut që zhvillon lëndën, vendin që zë lënda në formimin e studentit si dhe njojuritë dhe aftësitë që i jep lënda studentit. Syllabusi përmban edhe cështjet e detajuara për secilën temë, literaturën për secilën temë, sipas kërkesave të VKM përkatëse, formën e kontrollit dhe literaturën finale.								
Kriteri 7. Përbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Ndryshimet e programeve ndodhin nëfillim të vitit akademik, me riparaqitjen e programeve. Ky është një proces që ndodh natyrshëm dhe nuk ka një dokument që identifikon ndryshimet, por edhe nga pyetjet në vizitat në terren dhe sidomos intervista me pedagogët e departamentit dhe të programit, është identifikuar se ka ndryshime që paraqesin zhvillimet e tregjeve dhe literaturat bashkëkohore, si dhe bazuar mbi formimin dhe zhvillimin në karrierë te pedagogëve. Edhe kërkesa aktuale për akreditim ka ardhur si rrjedhim i identifikimit të nevojës për ndryshime në program, të përshtatshme me kërkesat e tregut të punës, të cilat u verifikuan të ishin më tepër se sa thjesht ndryshime minore, por ndryshime që kërkonin riorganizim të programit të studimit.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						


Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Duke iu referuar Ligjit 80/2015 "Për arsimin e Lartë në RSH", neni 70 pika 4, programet e studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë organizohen në tre cikle të njëpasnjëshëm, i parë, i dytë dhe i tretë, sipas nivelit 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Rregullorja dhe Statuti i UET parashtronjë se ofrohen programe të studimeve në tre cikle. Ndërsa diploma e MP në Marketing me profile, përfshihet në nivelin 7 të Kornizës së Kualifikimeve, në kualifikimet profesionale (grupi 2). Ngarkesa e programit përmban 60 kredite të shtrira përgjatënjë viti akademik në dy semestra, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesa në orë mësimore dhe orë jashtë auditorit gjendet në Planin mësimor të programit.
Kriteri 2. Emërtimi, përbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi i diplomës së Nivelit të dytë Master profesional në "Marketing me profile", është specifisht i përcaktuar në dokumentin e kurrikulës, programit mësimor, planit, rregulloreve përkatëse si edhe lëndëve. Ai është emërtim i ndryshuar nga emërtimi i hapjes fillestare të programit të studimit, kryesisht në emrat e profileve, të cilat janëndryshuar duke u specifikuar më shumë, janë shtuar ose hequr. Ky program diplomon menaxherë marketing, të cilët supozohet të punësohen në fusha të caktuara sipas profileve të përcaktuara. Lëndët bazë dhe formuese janë nëfunksion të krijimit të aftësive dhe njohurive e kapaciteteve si menaxherë të marketingut. Lëndët me zgjedhje synojnë në krijimin e aftësive specifike, të nevojshme për punësimin e studentëve. Bazuar mbi syllabuset dhe emëritimet përkatëse të lëndëve me zgjedhje për secilin profil, gjykojmë se në dy prej profileve, duhet të sygjerohen lëndë më të lidhura me formimin përkatës. Konkretnisht në profilin "Turizëm", vetëm njëra prej lëndëve lidhet specifisht me formimin e menaxherit të turizmit, ndërsa lëndët e tjera mund të fokusoheshin më shumë tek marketingu turizmit, ndërkohë që jepin vetëm njohuri marketing. Gjithashtu në profilin "Inovacion" përfshirja e lëndës Marketing ndërkombëtar është e palidhur me specialitetin. Kjo lëndë hyn kryesisht në lëndë karakterizuese në programin marketing dhe nuk është formuese lidhur me inovacionin. Përvec njohurive dhe aftësimit të studentëve në fusha specifike sic është emërtimi dhe përbajtja e veprimtarive jepin mundësi punësimi, sidomos në kushtet e Shqipërisë ku profilet



	e parashikuara janë me rëndësi për ekonominë dhe punësimin.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënësit dhe aftësimit profesional.	Më lart u evidentua mënyra e shpërndarjes së krediteve nëvitin akademik, vlerësimi në kredite e orë mësimore. Ndikimi i kësaj shpërndarjeje në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit mund të analizohet bazuar në dokumentat e syllabuseve, rregullores së programit, objektivave të shprehura aty. Në rregulloren e studimeve të programit shprehen qartë objektivat e programit në aspektin profesional, sidomos mekoncepte të specializuara dhe aplikuara, të lidhura ngushtë me profesionet e rregulluara apo licencuara etj. Të gjitha lëndët kanë një numër të barabartë kreditesh dhe si rrjedhim një kërkesë për punë të njëjtë për orët në auditor dhe jashtë tij si punë të pavarur të studentit. Kjo shpërndarje e ngarkesës, pak a shumë uniforme krijon mundësi për njëgjashmëri me programe të tjera studimi. Rezultatet e nxënësit dhe aftësimit individual gjithsesi mundësohen nga një përpjekje për të krijuar një raport të drejtë midis teorisë dhe praktikës në kurse të ndryshme sipas syllabuseve. Përbajtja e syllabuseve është e ndërtuar lidhur me specializim dhe aftësim sa më shumë lidhur me njohuri dhe raste specifike studimore.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë, është në përputhje me profilin e programit Masterdhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimet përkatëse, ngarkesa në kredite, si edhe raporti teori praktikë janë në përputhje me profilin e programit Master Profesional në Marketing me profile. Sa i përket ngjashmërisë me programe ndërkombëtare, bazuar mbi intervistat në institucion, konkretisht me dekanin dhe shefin e departamentit, duhet theksuar se ideja kryesore vjen nga vetë orientimi i fakultetit dhe departamentit nga tregu dhe marrëdhëniet me aktorë dhe institucione të lidhura, si dhe përshtatje me disa kurrikula ndërkombëtare. Por programi nuk ka referenca të lidhura me programe ndërkombëtare të njohura ose jo. <i>Si rrjedhim GVJ sygjeron se në rastet e sipërpërmendura të nevojshme për reflektim mbi lëndët, kjo të bëhet bazuar mbi programe ndërkombëtare, për përzgjedhjen e lëndëve, emërtimeve dhe programeve që japing aftësi të lidhura me profilin.</i>
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,	Ndarja në veprimtari formuese bazëështë bërë në funksion të një raporti thuajse të njëjtë midis njohurive të përgjithshme për një menaxher marketing dhe njohurive specifike lidhur me sektorë apo specializime specifike tek modulet/lëndët me zgjedhje/të profilit. Kryesisht kjo është bërë e mundur përmes



transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>dhënies së më shumë krediteve tek lëndët e profilit, të cilat janë në grupin e lëndëve me zgjedhje. Pesha e lëndëve të profilit është pesha maksimale e lejuar nga aktet ligjore e nënligjore, e barabartë me peshën e lëndëve karakterizuese, e cila ka minimumin e kërkuar nga legjislacioni. Kjo shpërndarje mundëson mobilitetin apo transferime, pasi lëndët bazë dhe karakterizuese janë të përgjithshme dhe kryesisht të vendosura në çdo program studimi të marketingut, ndërsa lëndët specifike mund të shërbejnë për transferime në programe që janë specifike. Megjithatë, transferimet mund të mos mundësojnë transferim të të gjitha krediteve të marra, por vetëm një pjese të tyre, pikërisht për shkak të peshës më të madhe se zakonisht të krediteve me zgjedhje.</p> <p><i>(Evidenca 28 paraqet rregullat për transferimin e krediteve dhe mobilitetet)</i></p> <p>Mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit evidentohen në aneksin e rregullores së programit të studimit dhe në RVB. Gjithashtu në marrëveshjet e bëra për internshipet/praktikat mësimore si edhe punësim të mundshëm të studentëve dhe përfshirjen e bizneseve e cila është në rritje. Megjithëse <i>nuk ka të dhëna të sakta mbi punësimin aktual të studentëve</i> pikërisht në këtë program studimi, bazuar mbi intervistat në institucion me pedagogët e programit studentët e këtij programi gjatë vitit të kaluar akademik kanë qenë thuajse 100% të punësuar. <i>Nuk u mundësua të konfirmohej përmes intervistave me studentët e programit, se sa ka ndikuar formimi aktual me profile në një mundësi aktuale apo të ardhme punësimi më të mirë.</i></p>
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Bazuar mbi intervistat në institucion, syllabusetë lëndëve të programit të studimit rishikohen dhe përmirësohen në fillim tëçdo viti akademik, duke përdorur literaturë bashkëkohore të pesë viteve të fundit. Pjesë e procesit të rishikimit është sëpari monitorimi i syllabuseve (<i>evidencë 37 format për monitorimin e syllabuseve</i>), ku evidentimi i problemeve çon në rishikimin e tyre. Çdo lëndë ka literaturë të detyruar dhe ndihmëse e rekomanduar, edhe sipas temave përkatëse, duke u ardhur në ndihmë studentëve për formimin e tyre teorik dhe praktik.
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfthimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njojurive mbi marketingun strategjik, kërkimin marketing, marketingun e shërbimeve, si njouri të përgjithshme, si edhe aftësive në fusha të vecanta, si turizmi, inovacioni, marrëdhëniet publike dhe politike etj, sipas profileve.	Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfthimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njojurive mbi marketingun strategjik, kërkimin marketing, marketingun e shërbimeve, si njouri të përgjithshme, si edhe aftësive në fusha të vecanta, si turizmi, inovacioni, marrëdhëniet publike dhe politike etj, sipas profileve.



	<i>Nuk ka ndonjë evidence specifike për identifikimin e të dhënave mbi punësimin e studentëve si dhe analiza të ecurisë bazuar mbi vlerësimin e përmbajtjes së programit.</i>								
Kriteri 8 Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Duke u bazuar në (<i>pikën 3.3.2 të evidencës 7 - Rregullores së programit të studimit</i>), programi është i organizuar për të siguruar aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional nëpërmjet aspektevepraktike dhe aplikative në cdo kurs; mundësi për stazh, internship të zgjeruar në operatorët kryesorë të tregut të punës; përfshirje në shoqatat profesionale, korporatat profesionale; përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e rregulluar ose licencën/at.								
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ndikimi i përmbajtjes së programeve në vijim të studimeve apo punësim dhe përshtatjen me pritshmëritë e tregut e pasqyron procesi i gjurmimit të studentëve, qëështë një garanci për gjetje të bazuara në të dhëna reale. Nga vizitat në institucion përkatësisht në intervistat me Qendrën e Alumni dhe Karrierës, u morën të dhëna mbi procedurën e komunikimit me Bordet e tregut të punës dhe mënyrën e ngritjes së tyre, për të përfituar sa më shumë për lidhjen me kërkesat e tregjeve të punës. Organizimi i programit përfshin edhe një marrëdhënie institucionale me Alumni nëpërmjet Bordeve të Tregut të Punës, të cilat janë burimi kryesor i përshtatjes së programit për të garantuar formimin e duhur profesional të studentëve lidhur me kërkesat e tregut të punës.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standartet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Bazuar në Ligjin 80/2015, personeli akademik me kohë të plotë dhe ai me kohë të pjesëshme kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbime në mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillime për studentët etj. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimir shkencor dhe kategorizohet në profesorë, lektorë dhe asistent lektorië.



	<p>Personeli akademik i Departmanetit te Menaxhimit dhe marketingut dhe ai jashtë departmanetit që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbush kushtet sipas ligjit, lidhur me rolin që realizojnë në mësimdhënie dhe aktivitet kërkimor shkencor duke u bazuar në titujt dhe gradat.</p> <p>Nga të dhënat që morëm gjatë vizitës në institucion rezultoi se për vitin akademik 2019-2020 për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 14 personel akademik, nga ku 12 personel akademik efektiv(PAE) dhe 2 personel akademik me kontratë (PAK), nga ku 12 me grada/tituj.</p> <p>Pra raporti PAE/PAK për këtë vit akademik është 12 / 2.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 85% PAE.</p> <p>Ngarkesa e stafit është shpërndarë sipas VKM, me jo më shumë se 3 lëndë në semester.</p>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>Personeli akademik i përcaktuar për të realizuar programin është i kualifikuar sipas kërkesave të legjisacionit dhe po ashtu në përshtatje me programin që nga përgjegjësi i Departamentit e në vijimësi me profesoratin e departamnetit. Bazuar në CV-të e stafit, vemë re se ka kualifikimet e duhura për mbështetjen e drejtimit të programti dhe mbulimin e moduleve mësimore të programit.</p> <p>Numri dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi, për dy vite akademike është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 11 pedagogë gjithsej,nga ku 9 personel akademik efektiv (PAE), të gjithë me tituj/grada.(sipas DVV)</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 81% PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është14 pedagogë gjithsej, nga ku 12 personel akademik efektiv (PAE), nga ku 11me tituj/grada dhe 1 Msc.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është 85% PAE.</p>
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe	<p>Përcaktimi i ngarkesave për stafin akademik është bërë në përputhje të kualifikimit të secilit anëtar të stafit me përbajtjen e programit dhe specifikën e lëndëve.</p> <p>Evidenca shtesë e kërkuar gjatë vizitës në institucion mbi stafin akademik të programit të studimit paraqet stafin prej 10 personel akademik efektiv (PAE), me tituj dhe grada, dhe 2 pedagogë PAK të cilët jepin mësim në këtë program.</p>



specifikën e moduleve të tij.	<p>Në këtë evidencë nuk paraqiten pedagogët të cilët kanë ngarkesën e lëndëve të profilit TV dhe Multimedia. Gjithashtu nuk paraqiten evidence për ngarkesën totale të pedagogëve (që mund të jetë e shpërndarë edhe në programe te tjera studimi). (<i>Evidencia 24 stafi akademi i programit të studimit</i>) ka një pedagog më pak se sa evidence shtesë e cila paraqet gjithashtu edhe ngarkesat mësimore të stafit për programin e studimit.</p> <p>Në tërësi programi i studimit ka në total 3 Prof.Dr PAE, 4 Prof.As, 3 PAE dhe 1 PAK, 4 lektorë me gradën shkencore Doktor/ PhD, PAE dhe 1 asistent leckor PAK me gradën Msc.</p> <p>Bazuar në CV e personelit akademik, në pjesën më të madhe dhe mbizotëruese të rasteve, ka përshtatshmëri të fushave kërkimore të shprehura nëkualifikimet, artikujt e botuar dhe angazhimet në trainime e projekteve të stafit, me fushat e mësimdhënies të përcaktuara. Ngarkesa e stafit akademik është në përputhje me programin e studimit dhe specifikën e moduleve.</p>
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Personeli përgjegjës për praktikën profesionale, është personel i departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, dhe të këtij programi studimi. Për provimin e praktikës organizohet komisioni i praktikës profesionale. Janë 35 kompani dhe institucione ku janë realizuar praktikat mësimore të studentëve të programit të studimit, si edhe ka marrëveshje me 8 institucione të kategorive të ndryshme për realizmin e praktikave mësimore. (Evidencat e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe evidence 34 e listës së gjithë institucioneve që kanë marrëveshje bashkëpunimi).</p> <p>Procesi i praktikave, pasqyrohet në (<i>evidencën 32.1. pika B. I. 7</i>), dhe është një bashkëveprim midis koordinatorit të departamentit, pedagogut përgjegjës dhe studentit, ku secili ka përgjegjësitë etij. Gjithashtu institucioni ku zhvillohet praktika duhet të vendosë një mbikqyrës i cili ndjek procesin dhe plotëson formularin e praktikës së studentit. Ky i fundit plotëson në fund një formular vetylëresimi, (<i>evidence 32.2</i>).</p> <p>Në përfundim të studimeve realizohet punimi i diplomës, ku vendoset në dispozicion personeli akademik udhëheqës i diplomës, brenda departamentit ose dhe nga jashtë departamentit nëse vlerësohet e nevojshme, sigurisht me titujt dhe kualifikimet përkatëse. Pedagogët marrin ngarkesë prej jo më shumë se 10 tema diplome në udhëheqje për programet e studimit të ciklit të dytë. Bazuar mbi intervistën në institucion, jo të gjithë studentët realizojnë diplomimin përmes punimit të diplomës. Një pjesë e tyre bazuar mbi kriteret marrin</p>



	temëdiplome, ndërsa pjesa tjetër diplomohen bazuar mbi provimin e diplomës, i cili organizohet nga departamenti.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mëdiseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Ky program studimi nuk ka personel ndihmës mësimor pasi është konsideruar i paaplikueshëm, për shkak se nuk ka lëndë me ngarkesë në laboratore apo mëdise të tjera specifike. <i>Gjithsesi në të ardhmen mund të konsiderohet përfshirja e laboratorëve sidomos në profilet inovacion dhe TV multimedia, pasi janë profile me lëndë me natyrë praktike dhe nevojë për formim me software përkatës.</i>
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht X

Standardi II. 6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Bashkëpunimin me tregun e punës UET e ka ndërtuar përmes Bordeve të Tregut të Punës (BTP), të cilët funksionojnë përmes mbledhjeve periodike, dy herë në vit. Ato janë krijuar fillimisht nga Alumni të UET dhe duke u zgjeruar me aktorë të tjera të lidhur me ta. Sipas vizitës në institucion me Zyrën e karrierës dhe Alumni, këto diskutime dhe mbledhje shërbijnë ndër të tjera edhe për të marrë informacion se cfarë kërkon tregu nga profesionistët, dhe si rrjedhim UET dhe departamenti Menaxhimit dhe Marketingut nxjerr rezultate lidhur me përmirësimet. Një gjë e tillë ndodhi edhe në rastin e propozimit për rishikimin e programit aktual të studimit MP në Marketing me profile.
Kriteri 2 Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato	Studentët përfshihen nga institucioni në diskutime lidhur me mbarëvajtjen e lëndëve, programeve, cilësinë e mësimdhënies dhe përmirësimin e programeve përmes procesit të grupeve të fokusit, të cilat zhvillohen në kohë të caktuara dhe evidentohen nga vizita në institucion si efektive për marrjen e informacioneve të dobishme nga studentët.

janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	
Kriteri 3 Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Institucioni mban kontakte me studentët e diplomuar. Metodat e mbajtjes së kontakteve, sipas intervistës me zyrën e Alumni, janë përmes adresave e-mail, numrave të telefonit, por sidomos edhe përmes rrjeteve sociale, ku sot është më e lehtë të gjenden pjesa më e madhe e tyre. Edhe kontributi i tyre është përmes përfshirjes ne BTP, dhe jo në ndonjë mënyrë të vecantë. Pra ata ftohen të jenë pjesë e BTP dhe në këtë mënyrë e japin kontributin.
Kriteri 4 Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institacioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Nuk ka ndonjë mënyrë të veçantë të ruajtjes së kontakteve me njësitë e pushtetit vendor, përvecse në rast se ata janë pjesë e BTP, si më sipër.
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht X
---	---

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për	Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse e programit të studimit në bashkëpunim me SBC kujdeset për monitorimin e procesit mësimor dhe garantimin e



zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	mësimdhënies cilësore duke marrë veprime konkrete përmirësuese në nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. UET angazhon personelin akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit e cila i mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës. Gjithashtu përmes sistemit LMS, UET ka mundësi të aplikojë format e të mësuarit e-learning, përmes ofrimit të materialeve në sistem elektronik si video, teste, forume, animacione te cilat ndihmojnë personelin të krijoje metoda më novatore dhe të standartizuara të mësimdhënies.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe innovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nga SBC në bashkëpunim me struktura përgjegjëse për zhvillimin e monitorimit gjatë mësimdhënies të përbërë nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe përgjegjësat e grup-lëndëve. Procesi realizohet duke përdorur disa procedura dhe instrumenta si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i provimeve në sezonin e provimeve përfundimtare, ku kontrollohet mënyra e vlerësimit dhe procedura e rivlerësimit të studentëve. Rezultatet pasqyrohen në raportet përkatëse; - Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët përmes fokus grupeve dhe anketimit semestral të tyre. Pas zbardhjes së intervistave te focus grupeve hartohet raporti i cili u vendoset në dispozicion departamenteve përkatëse; - Vlerësimi i procesit të mësimdhënies nga ekspertë të jashtëm në drejtimin e rektorit 1 herë në 2 vjet; - Dokumetim i performances akademike nga stafi akademik, i cili në mënyrë periodike pasqyron ngarkesën mësimore, veprimtarinë akademike, performancën në kërkim shkencor dhe shërbimet ndaj të tretëve;
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimoreve.	UET bën vlerësime periodike të mësimdhënies nga studentët përmes metodave të fokus grupeve dhe anketimeve. Anketimi hartohet nga KSBC dhe synon mbledhjen e opinionit të studentëve lidhur me procesin e mësimit dhe cdo dukuri tjetër të lidhur me të. Ky proces ndodh dy here në vit, në përfundim të semestrit dhe përpëra sezonit të provimeve për të evituar ndikimin në vlerësim. Rezultatet e anketimit janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore së bashku me intervistat e zbardhura të focus grupeve periodike.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) u vë në dispozicion vlerësimet drejtuesve të institucionit, drejtuesve të njësisë si edhe në mënyrë të personalizuar secilit pedagog. Sic u pohua dhe nga takimi me KSBC ato janë matësi kyesor i cilësisë së mësimdhënies në UET.</p> <p>Rezultatet e tyre diskutohen në mbledhjet e departamentit dhe</p>




	shoqërohen me marrjen e masave korrigjuese.						
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga takimet e zhvilluar me KSBC dhe Përgjegjësen e Programit MP Marketing u pohua se rezultatet e gjeneruara nga vlerësimet bëhen publike në mbledhjet e departamentit dhe promovohen shembujt e praktikave më të mira.						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Përbushjet përmes pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesisht</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td>X</td></tr> </tbody> </table>	Përbushjet përmes pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht			X
Përbushjet përmes pjesërisht	Përbushjet kryesisht	Përbushjet plotësisht					
		X					

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjeter e miratuar nga institucioni.	<p>Në programin e studimit MP Marketing me 5 profile, format kryesore të mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Leksionet (2 orë në javë për çdo lëndë); Seminare (1 orë në javë për çdo lëndë); Projekte/Detyra, (pjesë e vlerësimit të lëndës); Praktikë profesionale; Seanca metodologjike për hartimin e tezës së diplomës (por ato duhen shprehur ne ECTS). <p>Metodat e transferimit të njohurive tek studentët janë bashkëkohore dhe përfshijnë mjete audio-vizive dhe sistemin online LMS që ndihmon në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nga takimi me studentët u evidentuan lehtësirat e sistemit LMS në rritjen e interaktivitetit me pedagogun dhe jashtë auditorit.</p>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e	<p>Nga takimi i zhvilluar me studentë të programit u theksua se zhvillimi i orëve interaktive i lejon ata të pershihen më tepër dhe ndihmon mësimnxënien. Gjithashtu diskutimet dhe puna në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit nxisin të menduarit kritik Gjithashtu përdorimi i rasteve reale të bizneseve për studim janë në përputhje me përbajtjen praktike dhe aplikative të Masterit Profesional Marketing.</p> <p>Sic u pohua dhe nga studentët, pedagogët janë të gatshëm të</p>



aktivitetete formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	përgjigjen dhe asistojnë studentët për cdo paqartësi.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxenit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	UET trajnon pedagogët e jashtëm e të brendshëm mbi specifikat e rregullores së UET, metodat didatike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Pjesë e rëndësishme e trajnimeve është përdorimi i sistemit të brendshëm të komunikimit me studentët, LMS, për sigurimin e çdo materiali teorik lidhur me përbajtjen e lëndës, detyrat e kursit dhe vlerësimet. Në funksion të moduleve aplikative, janë vënë në dispozicion të studentëve salla kompjuterike të pajisura me programe kompjuterike bashkëkohore, ku studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike. Këto kapacitete janë në avantazh të personelit akademik për të krijuar një mjeti më të mire për transferimin e dijeve tek studentët.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	<p>Personeli akademik i perfshirë në programin e studimit MP Marketing me profile përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Stafi akademik mban gradën professor dhe doktor në përputhje me ciklin e studimit ku jepin mësim. Personeli akademik është i angazhuar në kërkim shkencor. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies.</p> <p><i>UET ka hartuar kurrikulat mësimore në përshtatje me kërkesat e tregut, por GVJ sugeron të rishikohen lëndët e profilit duke vlerësuar se në ciklin e dytë të studimeve master njohuritë dhe aftësitë e studentëve duhet të avancohen në drejtim të profilit të zgjedhur.</i></p> <p>Për cdo lëndë pedagogu rekomandon 2-3 tekste bazë. <i>GVJ rekomandon të bëhet një përzgjedhje e kujdeshshme nga ana e stafit e titujve vendas dhe te huaj, vecanerisht të lëndëve të profilit dhe adoptim i literatures ekzistuese ne gjuhen shqipe si dhe përkthim profesional i titujve kyc.</i></p> <p>Nga shqytrimi i CV-ve dhe dokumentacionit të personelit akademik, u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në ASCAL rezulton se plani mësimor mbulohet nga pedagogë të brendshëm në masën 80%. Stafi akademik është i angazhuar në këshillim për studentët dhe ndihmon e asiston ne detyra administrative.</p>



<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se departamenti realizon kontolle lidhur me disiplinën e procesit mësimor. Departamenti mblidhet periodikisht për të evidentuar arrijet dhe problematika që duhen përmirësuar.</p> <p>Për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies përfshihen dhe studentët të cilët mblidhen cdo muaj dhe evidentojnë çdo lloj problematike të mundshme lidhur me procesin mësimor. Sugjerime nga ana e studentëve vlerësohen nga departamenti në përmirësim të mësimdhënies. Në funksion të përmirësimit të procesit shërben edhe anketimi me studentët ku vlerësimet e studentëve lidhur me pedagogun, lëndën dhe format e metodat e mësimdhënies merren në konsideratë për përmirësime të vazhdueshme.</p>						
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga takimi që GVJ realizoi në institucion, evidentoi se mësimdhënia është interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale krijon interes dhe përfshirje të studentëve në zgjidhje analitike të rasteve. Ndër metodat innovative për përmirësimin e procesit mësimor përfishet Moodle- aplikacion LMS (Learning Management System), i cili mundëson menaxhimin e materialeve mësimore dhe procesit mësimor me krijimin e Web faqeve dinamike për studentët dhe pedagogët. Materialet didaktike të përdorura përbëhen dhe nga materiale audivizuale të cilat krijojnë situata diskutimesh interaktive dhe nxisin punën në grupe të studentëve.</p>						
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Metodat interaktive të mësimdhënies përqëndrohen tek aftësitë, mundësitë dhe interesat e studentëve. Personeli akademik i programit të studimit nxit studentët të ndërrmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në përgatitjen e detyrate të kursit në të cilat studentët vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre. Gjithashtu pedagogët kujdesen të angazhojnë studentët në projekte kërkimore dhe në debate shkencore. Vecanërisht gjatë hartimit të mikrotezës, pedagogët ndihmojnë studentët në formimin e kompetencave dhe aftësive profesionale sipas profileve përkatëse. Bashkëpunimi i ndësjelltë pedagog-studentë vihet re në auditor, në detyrat e ndryshme të kursit, në projekte e hartimin e diplomës.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushjet pjesërisht</th> <th>Përmbushjet kryesisht</th> <th>Përmbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushjet pjesërisht	Përmbushjet kryesisht	Përmbushjet plotësisht			X
Përmbushjet pjesërisht	Përmbushjet kryesisht	Përmbushjet plotësisht					
		X					



Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahan rregullisht.	<p>Procesi mësimor i programi MP Marketing me profile zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore: Godina A është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m^2 dhe Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m^2.</p> <p>Të dy godinat janë të ndara në: sala leksionesh, ku të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme. Gjithashtu studentët kanë në dispozicion bilbotekën 300m^2, laboratorë mësimorë informatike, si laboratori 205 B me 25 PC dhe video projektor, ai 206 B me 35 PC dhe video projektor, 207 B me 35 PC dhe video projektor, 208 B me 80 PC. Laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal EiFi, i cili ndihmon në procesin mësimor. Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit mësimor. Stafi i IT-së ishte i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimit. Nga vizita në institucion u vu re se me gjithë përpjekjen e institucionit për mirëmbajtjen e ambienteve, kishe disa mangësi në ruajtjen e standardeve në ambientet e përbashkëta.</p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Nga vizita e realizuar në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë, konstatuam se mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret e nevojshme për zhvillim e mësimdhënies cilësore. Në këto mjedise vëzhguam salla leksione e seminare, laboratorë, salla mbledhjesh, zyra e studio të përshtatshme për zhvillimin e këtij programi studimi. Të gjitha janë të pajisura me mjetet mësimore si kompjuter e video-projektor të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret teknike dhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas VKM nr 418, date 10.05.2017, është 2.5 m^2 për student. Laboratorët

	mësimorë janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e praktikës mësimore. GVJ u njoh me laboratorët e UET, në vecanti me Laboratorin e Novacionit, ku është instaluar dhe printer 3D, në të cilën studentët e MP Marketing me profile Multimedia dhe Novacion mund të zhvillojnë praktikën mësimore.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	UET ka vendosur në dispozicion të studentëve katër laboratorë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar të gjitha programet (softëare) për realizimin e punës së pavarur nga studenti. Këto laboratorë janë pajisur dhe përmes projekteve të ndryshme ndërkomëtare në të cilat ka marrë pjesë universiteti. Biblioteka gjithashtu është e pajisur me 8 kompjutera dhe me 150 vende leximi dhe disponon mbi 6000 tituj librash. Studentët kanë akses në bibliotekën elektronike, ku studentet dhe stafi mund të shkarkojnë artikuj shkencor, përkatësisht ne Ebsco, Sage abonim 5 vjeçar. Biblioteka ka një staf të gatshëm në ndihmë të studentëve. Procesi mësimor mbështetet nga sistemi LMS (Learning Management System), i cili bën të mundur që studenti të informohet nga pedagogu kudo që ndodhet dhe të ndërveprojë me kolegët e kursit online. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe konstatimet tona nga vizita në institucion, vlerësojmë se UET ka infrastrukture të konsoliduar për realizimin e programit mësimor.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën angleze. Baza mësimore që u ofrohet studentëve përfshin tekste mësimore, cikle leksione, leksione në ppt, materiale plotësuese. Nga vizita në bibliotekë rezultoi se titujt e teksteve mësimore nuk gjendeshin fizikisht, por mund të gjenden në bibliotekën elektronike si EBCSO, Emerald, Cambridge University, Questia.	Duke pasur në vëmendje që programi MP Marketing me 5 profile ofrohet në gjuhën shqipe, studentit nuk mund t'i vihet në dispozicion literature në gjuhën angeleze dhe të mjaftohet vetëm me leksione në ppt në gjuhën shqipe. <i>GVJ konstaton se mungon literatura bazë në gjuhën shqipe për programin MP Marketing, dhe sugeron të pasurohet fondi i bibliotekës me titujt e përfshirë në kurrikulat mësimore të lëndëve. Të përzgjidhet me kujdes literatura bashkëkohore dhe të bëhet një përkthim profesional i tituve kryesorë në gjuhën shqipe.</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të	Fondi i bibliotekës në gjuhën shqipe për modulet e programit MP Marketing është i vogël dhe tekstet mësimore të



mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	paraqitura në syllabuse nuk gjenden fizikisht në bibliotekë. Personeli akademik dhe studentët aksesojnë biblioteka virtuale si: Sage, Ebsco të cilat ofrojnë mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërtë me programin e studimit.	Sic u përmend dhe më sipër personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë online në të cilat UET është abonuar si virtuale si: Sage, Ebsco, Emerald, Cambridge University, Questia nga kudo ku ata ndodhen. Nga vizita në institucion rezultoi se biblioteka virtuale nuk përdoret shumë nga studentët.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	UET ka në dispozicion të studentëve 4 laboratorë mësimorë informatike të pajisur me programe risi në fushën e teknologjisë së informacionit. Gjithashtu ka dhe laboratorin e novacionit ku studentët mund të kryejnë në praktikë lëndët si Animacion 3D dhe Menaxhimi i Inovacionit. UET ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për studentët, por nga vizita rezultoi se ajo nuk shfrytëzohej mjaftueshëm prej tyre.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Ky kriter nuk aplikohet pasi UET nuk ka një sistem të mirëfilltë E-learning. UET ka në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për administrim, dokumentim, ndjekje, raportim dhe shpërndarje të materialevë mësimore nga pedagogët për studentët. LMS është i aksesueshëm online për të gjithë pedagogët dhe studentët.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Komunikimi i brendshëm realizohet si nëpërmjet adresave të Email-it të krijuara nga institucioni për stafin akademik, administrativ dhe studentët. Sic u përmend më sipër UET ka gjithashtu sistemin e komunikimit LMS. Përmes LMS studentët mund të aksesojnë Syllabusin e Lëndëve, leksionet e lëndëve, materialet në funksion të realizimit të lëndës dhe detyrat dhe vlerësimet përkatëse. Sistemi ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues të student apo pedagog. Studenti merr gjithë bazën didaktike për lëndën ndërsa ndërvepron me pedagogun dhe kolegët e tjerë të kursit.
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përgjedhjen e temëve të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon programi i studimit dhe departamenti. Udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet për konsultime dhe realizimin e tij. Udhëheqësi zhvillon seanca metodologjike në



	auditor me grupin e studentëve që udhëheq, për të garantuar shkrimin e punimit në përputhje me standartet e punimit shkencor. Udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e paraqitur nga studenti përpara mbrojtjes.						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th>Përbushjet pjesërisht</th> <th>Përbushjet kryesish</th> <th>Përbushjet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesish	Përbushjet plotësisht		X	
Përbushjet pjesërisht	Përbushjet kryesish	Përbushjet plotësisht					
	X						

Standardi III.4

Institucioni ngrë struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon strukturën njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, UET ka organizuar struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin ekuadrit rregulator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standartet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoronzbatushëmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit; - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit tëveprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë; <p>Veprimtaria e KSBC përfshin monitorimin e vazhdueshëm te institucionit në;</p> <p>Ndjekjen e vazhdueshme të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performances;</p> <p>Ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij;</p> <p>Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajta e cilësisë së tij;</p> <p>Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion.</p>



	Këto njësi ndjekin me përgjegjshmëri problemet që lidhen me mësimdhënien, vlerësimin institucional dhe zhvillimet mësimore në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Veprimtaria e tyre miratohet dhe rregullohet nga Senati i Universitetit.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Cilësia e procesit të mësimdhënies është në fokus të Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut si dhe Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit, të performances akademike-mësimore, këto dy njësi bashkëpunojnë ngushtësisht me KSBC-në për garantimine cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, të personelit akademik dhe të studentëve. Institucioni ofron mundësinë e trajnimeve dhe ëorkshopeve të ndryshme të cilat orientojnë personelin akademik dhe personelin mësimor-shencor në përditësimin dhe kualifikimin e mëtejshëm profesional. Gjithashtu për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies, ndiqen si praktikë leksionet e dhëna nga lektorë të ftuar vendas të cilët janë personalitete në fushën e tyre, por dhe të huaj, pjesë e të cilëve janë nga programi ERASMUS+. Të gjitha këto shkëmbime i shërbejnë rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitat përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	UET angazhohet në të nxënët teorik dhe praktik përmes metodave ndërvepruese. Pedagogët në Programin MP Marketing me profile, inkurajohen të zhvillojnë leksione me debate, diskutime brenda në klasë, punime individuale dhe në grupe. Personeli akademik bën të gjitha përpjekjet që studentët të kuptojnë konceptet dhe stimulon aplikimin e tyre praktik. Gjithashtu Departamenti i Menaxhimit e Marketingut në bashkëpunim me KSBC ka aplikuar metoda të ndryshme për kontrollin e shkallës së përvetësimit të lëndëve nga studentët. Në kuadër të rritjes së performancës mësimore dhe zhvillimit të metodave innovative kanë ndihmuar dhe specializimet e pedagogëve në Universitetet Perëndimore, pjesë e shkëmbimeve Erasmus+.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazdueshme në fushën e kërkimit shkencor përtë ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në planin strategjik të UET, prioritet është kërkimi shkencor. Kërkimi shihet si faktor kryq në promovimin e insitucionit dhe programeve të studimit. Stafi akademik është i organizuar në grupe kërkimore të cilat janë pjesë e Qëndrës Kërkimore - Shkencore përgjegjëse për kualifikimet në fushën e kërkimit shkencor. UET u ofron personelit akademik dhe atij kërkimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme përmes projekteve kërkimore me partnerë vendas

	dhe të huaj.Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe dosjeve personale të pedagogëve vihet re se personeli i angazhuar në këtë program është aktiv në publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore në fushat që përfshihen në programin e studimit.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>Referuar RVB Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut realizon leksione të hapura me pjesëmarrje pedagogë apo specialist të mirënjojur të fushës së marketingut, me synim marrjen e përvjës metodologjike dhe pedagogjike nga personeli akademik. Në dy vitet e fundit numri i stafit akademik të huaj që kanë sjellë përvjën e mësimdhënies në UET është 18 lektorë, ndërsa personeli akademik i UET që ka marrë përvjë ndërkontaktare në mësimdhënie në universitet perëndimore është 37 lektorë.</p> <p>UET ka ofruar trajnimeve dheëorkshope për personelin akademik si trajnimi me temë “Statistical Data Analysis of ESS 2012 Project” në kuadër të Anketës Sociale Evropiane (ESS) (Ëorkshop-i trajtoi metodat statistikore, që shërbejnë për të zhvilluar një projekt të tillë); (Ëorkshop “Use of Surveys as Research Method” (pjesë e trajnimeve dhe çertifikimeve që zhvillon Qendra për Kërkim Shkencor dhe Metodologji në UET); trajnimi UET -LMS per strafin akademik për metodat e reja të ndërveprimit digjital pedagog-student.</p>
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor. Institucioni ofron trajnime ndërkontaktare në kuadër të programit Erasmus+ për strafin akademik dhe personelin ndihmes akademik për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja nëpërmjet praktikës së leksioneve të hapura.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Institucioni ka realizuar zhvillimin e një sërë aktivitetesh me natyrë shkencore të tillë si konferanca, seminare, leksione te hapura me personalitete dhe lektorë të huaj, ku është nxitur pjesëmarrja e personelit akademik. Metodat e reja janë diskutuar nga stafi akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit dhe aplikuar tek studentët. KSBC analizojnë efektet e pritshmëritë e studentëve dhe i raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet Përgjegjësit të Departamentit, i cili rishikon metodat e mësimdhënies me strafin akademik.
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në	Nga analiza e RVB dhe vizita ne institucion rezulton se UET ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të

procesin mësimor angazhon në fazë të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	ngjashme nga vende të rajonit dhe Evropës, pjesë e programeve Erasmus+ dhe Erasmus Mundus. Bashkëpunime të tillë nxisin performancën e stafit akademik përmes shkëmbimit të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu stafi trajnohet vazhdimisht lidhur me hulumtimin dhe publikimin dhe mbështetet me mekanizmafinancimi, që nxisin angazhimin në projekte kërkimore me ndikim në botën akademike dhe politike.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nivel i përbushjes</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="background-color: #e0e0e0;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nivel i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nivel i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Bazuar në rregulloren e UET, format e kontrollit të dijeve përcaktohen në nenin 24 si më poshtë:</p> <p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtëm:</p> <p><i>24.1 Për lëndët e Tipologjisë I</i></p> <ul style="list-style-type: none"> a. Provimit përfundimtar (40%) b. Detyrave praktike: $2 \text{ (dy)} \times 30\% = (60\%)$ <p><i>24.2 Për lëndët e Tipologjisë II</i></p> <ul style="list-style-type: none"> a. Provimit përfundimtar (40%) b. Provimit të ndërmjetëm (30%) c. Detyrës së kursit (20%) d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%). <p>Lëndët e programit të studimit MP Marketing janë të tipologjisë II. Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. Syllabusi ngarkohet në sistemin LMS nga ku mund të aksesohet lehtësisht nga studentët.</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë	<p>Format e kontrollit të dijeve dhe pse gjenden në rregulloren e UET, u bëhet e ditur studentëveme programin e studimin,</p>



e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	syllabusin e lëndës, që në javën e pare të fillimit të mësimit nga pedagogu i lëndës. Studentët e programit të studimit mund të informohen edhe në distance përmes sistemit LMS në lidhje me lëndët, përbajtjen e tyre dhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Referuar RVB testimi e vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet në forma të ndryshme si: pjesmarja aktive; plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit); testimet gjatë vitit; Provimi përfundimtar. Vlerësimi i studentit ndahet në vlerësim i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, si dhe vlerësimi përfundimtar. Duke shqyrtuar Syllabuset e lëndëve rezultoi se raporti është në masën 40% (provimi përfundimtar) dhe 60% vlerësimi i vazhduar gjatë vitit (aktivizimi, detyra kursi, testime). Kjo formë inkurajon angazhimin aktiv të studentëve gjatë kursit.
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi gjatë vitit inkurajon angazhim dhe ndërveprim të studentit dhe e përgatit atë për sezonin e provimeve. Sic u përmend dhe në standartin III.6 raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me reportin përfundimar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të cdo semestri. Vlerësimi gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar gjenden në formë elektronike përmes sistemit LMS. Gjithashtu rezultatet e studentit dokumentohen në dokumenta si regjistri i pedagogut dhe pasqyra e vlerësimit dhe depozitohen në Sekretarinë Mësimore.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimt dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë formë të ndryshme abuzimi dhe rrisin	UET i kushton shumë rëndësi transparencës dhe privatësisë së vlerësimit. Vendosja e rezultateve në sistemin elektronik LMS, lejon secilin student të shikojë vetëm vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjeterit. Gjithashtu vlerësimi bëhet në kohë. Ndërkohë UET ka filluar



transparencën.	të përdorë format e vlerësimit në mënyrë elektronike (nëpërmjet Clean Score), një nga format bashkëkohore të kontrollit të njojurive dhe vlerësimi i studentëve. Kjo redukton abuzimin dhe subjektivitetin e vlerësimit të studentëve.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimit përfundimtar i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Cdo komision përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë, ku njëri është titullari i lëndës. Në rastin e mbrojtjes së Praktikës Profesionale, realizohet me komision me tre anëtarë, ku njëri prej tyre është përgjegjësi i praktikës për departamentin. Vlerësimi i praktikës është kusht për përbushjen e detyrimeve lidhur me kreditet e programit dhe me diplomimin.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njojurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Konfirmuar edhe nga Rregullorja e Programit të Studimit, të gjitha format e testimit me shkrim si të vazhduar ashtu dhe përfundimtare zhvillohen duke mbajtur anonim emrin e studentit, nëpërmjet procesit të sekretimit. Ky proces kryhet nga Koordinatori i Departamentit dhe Sekretaria Mesimore. Proceset e kontrollit të dijes zhvillohen konform të gjitha rregullave institucionale. Ambjenti i UET monitorohet me Kamera dhe Personeli i Sherbimit kujdeset për ruajtjen e sigurisë.
Kriteri 5. Vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studentët e MP Marketing në të gjitha lëndët zhvillojnë projekte, detyra kursi dhe raste studimore. Gjatë zhvillimit të tyre dhe në mbrojtjen e tyre studentët marrin këshilla dhe vlerësim nga pedagogu lidhur me aspektet pozitive dhe negative dhe cfare duhet të përmirësojnë. Ky process ndihmon studentët të përmirësohen në aspekte të mësimnxënies dhe të ballafaqimit me audiencën. Gjithashtu, sipas RVB vlerësimi i dijeve në provim shoqërohet me komente. Çdo provim përmban seksionin e vlerësimit të pedagogut për të argumentuar vlerësimin e tij. Pas se cilës detyrë apo provim, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Paskësaj seance pedagogu dorëzon proçesverbalin me rezultatet e studentëve.
Kriteri 6. Njësitet përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjinën në provime dhe detyra.	Rregullat e zhvillimit të kontolleve të dijes përcaktohen në dokumentat përkatëse të institucionit. Gjithashtu, në Rregulloren e UET, janë të specifikuara mjaft qartë dhe penalitetet për rastet e konstatimit të kopjimit ose plagjiaturës. Gjatë zhvillimit të provimit ndalohet hyrja e personave të

	jashtëm me përjashtim të pedagogëve të autorizuar për mbikqyrje. Gjatë provimit ndalohet celulari dhe personi që përdor mjete të tilla të palejueshme përjashtohet nga provimi.								
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Përmes sistemit online MOODLE UET LMS, studenti informohet brënda afateve të përcaktuara nga institucioni për rezultatet e provimit. Sipas rregullores se UET, dorëzohen tezat e korigjuara brenda një javë nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa seancat sqaruese dhe rishikuese bëhen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të provimit. Stafi akademik dorëzon rezultatet e vlerësimit të seminareve dhe detyrave të kursit, gjatë javës së 14-të të semestrit, duke ju përmbajtur afatit përkatës. Studentët njihen me rezultatet para datës së zhvillimit të provimit përfundimtar.								
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njojur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Ne pikën 5.7 të rregullores së programit të studimit janë pasqyruar kushtet dhe procedurat për rishikimin e vlerësimit. Institucioni ka dokumentacion të plotë që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njojur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloren dhe procedurat e vlerësimit.								
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankirim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas pikes 5.7 te rregullores, studenti ka të drejtë të ankimojë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës. Ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ngrë një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vlerësimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë dokumentohet dhe arkivohet.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njoħuri të thelluara të kompetencave profesionale e

shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Marketing”, me profile: 1. Turizëm; 2. Inovacion; 3. Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh; 4.TV Multimedia; 5. Marrëdhënie Publike Politike.</p> <p>Programi i studimit synon të pajisë studentin me njohuritë teorike bazë të Marketingut, aftësitë praktike dhe aftësi për zhvillim karriere në profilin e zgjedhur në përputhje me tregun e punës. Kurrikula e programit të studimit përmban 5 kategori përmes të cilave studentët fitojnë një grup kopetencash të ndara në A) Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme B) Përgatitje për disiplinën shkencore C) Profili D) Lëndë plotësuese E) Detyrime përmbyllëse. Sipas ketyre kategorive programi përbëhet nga 9 lëndë , përkatësisht A) Lëndë Bazë : 1 Metoda kërkimi të avancuara ; B) Lëndë Karakterizuese: 1. Kërkimi marketing 2. Marketing Shërbimesh 3. Marketing Strategjik; C) Lëndë ndërdisiplinore: 3 lëndë të grupuara sipas profilit të zgjedhur - Turizëm; Inovacion; Menaxhim dhe vlerësim projektesh ; TV multimedia, Marrëdhënie publike politike; D) Lëndë plotësuese: 1. Praktike dhe Zhvillim Karriere; E) Detyrime përmbyllëse: 1. Punimi i diplomës/Provim i përgjithshëm formim.</p> <p>Në këtë program studenti mer 6 kredite nga Lënda Bazë, 18 kredite nga Lëndët Karakterizuese, 18 kredite nga Lëndët ndërdisiplinore, 6 kredite nga Lëndë plotësuese dhe 12 Kredite nga Detyrimi përmbyllës me punim diplome ose provim formimi.Të gjitha lëndët zhvillohen sipas Tipologjisë II, në mënyrë interaktive leksione e seminare nga lektorë me të paktën gradën shkencore “Doktor” e të specializuar në fushat përkatëse. Ngarkesa është e balancuar mes semestrave dhe lëndët ndjekin një radhë që është e nevojshme për përvetësimin e tyre.Në syllabuset e detajuara janë specifikuar kopetencat që fitojnë studentët në secilën lëndë të programit të studimit.</p> <p>GVJ rekomandon të rishikohen lëndët bazë, lëndët karakretizuese dhe lëndët e profileve përkatësisht:</p> <p><i>Lënda Bazë “Metoda kërkimi të avancuara” përsëritet në</i></p>



	<p>Lëndë Karakterizuese “Kërkimi marketing” dhe nuk paraqet vlerë të shtuar për rastin e masterit profesional, por vetëm në rastin e masterit shkencor.</p> <p>Lënda bazë e Programit Master Marketing duhet të jetë brenda ideologjise formuese praktike në Marketing. Propozojmë të shihet mundësia e zëvendësimit me lëndë bazë formuese në marketing si lënda Menaxhim Marketing/Marketing strategjik dhe/ose Planifikim Marketing, ku mund të vendoset edhe një modul midis këtyre.</p> <p>Në Lëndët Karakterizuese rekomandohet të merren parasysh lëndët Komunikim i Integruar Marketing dhe Menaxhim Marke, në rast të zëvendësimit të lëndës së Marketingut strategjik. Të dy lëndët e propozuara janë në qëndër të cdo kurrikule Marketing sot në botë.</p> <p>Lëndët ndërdisiplinore në Profilin Turizëm nuk thelojnë njohuritë dhe nuk zhillojë aftësitë profesionale të studentit në turizëm. Në grupin e lëndëve të Turizmit gjendet vetëm një lëndë Turizëm e titulluar “Menaxhimi i Mikepritjes dhe Turizmit”. Kjo lëndë nuk mund të justifikojë të gjithë profilin. Sugjerojmë që është domosdoshmëri të thellohen njohuritë e menaxhimit dhe marketingut e shërbimeve turistike me lëndë specifike dhe shumë të lidhura me turizmin aktualisht si Turizmi i Qëndrueshëm, marketing i turizmit, apo E-turizmi, në vend të lëndëve të komunitetit si “Marketingu digital dhe media sociale; Komunikimi marketing i integruar”.</p> <p>Lëndët ndërdisiplinore në Profilin Inovacion nuk thelojnë njohuritë dhe aftësitë profesionale të studentit në inovacion. Në grupin e lëndëve të Inovacionit gjendet vetëm një lëndë Inovacioni, e emertuar “Menaxhimi i Inovacionit” ndersa lënda Marketingu ndërkombëtar mund të zhvendoset nga Lëndë ndërdisiplinore në Lëndë Karakterizuese.</p> <p><i>GVJ sugjeron të pasurohet literatura bazë e detyruar me tekste në gjuhën shqipe.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Të gjitha lëndët në programin e studimit zhvillohen sipas Tipologjisë II, në mënyrë interaktive leksione e seminare. Kjo u jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësi praktike përmes detyrave dhe projekteve/raste studimore dhe diskutime të hapura. Gjithashtu, këto u lejojnë studentëve aplikimin e njohurive, teknikat dhe aftësitë për të zgjidhur problemet e kësaj industrie. Në profilin TV dhe multimedia studentët ofrojnë mundësinë e zhvillimit të aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, të komunikimit dhe

	ndërveprimit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit paraqiten në syllabuset e cdo lëndë në seksionin “Përbledhje dhe qëllimet e kursit”. Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave të rezultateve përfundimtare të lëndës të cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektimi të mëtejshme lidhur me qëllimet e programit të studimit.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në javën e fundit të semestrit pedagogët realizojnë një seance konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me cështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në përcjelljen e informacionit mbi zhvillimet e reja të shkencës kanë shërbyer leksionet e hapura me të ftuar nga industria dhe pedagogët e huaj të ardhur përmes programeve të shkëmbimit Erasmus+. Në syllabuset e lëndëve reflektohen orët e programuara për zhvillimin e orëve të hapura dhe seminareve me të ftuar nga bota e biznesit për diskutimet e çështjeve lidhur me zhvillimet më të fundit në fushën e lëndës.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njojuritë e marra në laboratori dhe praktikat profesionale.	Pas dhënies së informacionit teorik për grup kopetencash, studentët testohen ti aplikojnë ato në praktikë duke punuar në grupe pune, tre ose kater studentë, puna e të cilëve materializohet në detyrë kursi, rast studimi, stimulim i zgjidhjes së një problem biznesi. <i>GVJ thekson domosdoshmérinë e konkretizimit të teorisë në praktikë për të gjitha modulet e programit të studimit. Mbi të gjitha lëndët e profileve duhet të konkretizojnë njojuritë e specializuara të profilit me raste praktike.</i> Gjithashtu, praktika profesionale u shërben studentëve si faze reflektimi mbi kompetencat e fituara dhe qasjen ndaj zgjidhjeve të problemeve praktike.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukton studentët sipas grupeve të punës në lidhje me realizimin e detyrës së caktuar dhe stimulon zgjidhjen e një problemi biznesi. Në këtë proces personeli akademik mbështet idetë innovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat të
Kriteri 8. Personeli akademik	



krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	cilit kanë nevojë për thellim teorik dhe studim të mëtejshëm. Këto probleme ndodh të bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme dhe prej tyre të zhvillohen tema masteri në finalizimin e studimeve.UET e ka pjesë të strategjisë kërkimore përfshirjen e studentëve në kërkime shkencore. Sipas RVB studentët janë përfshirë në konferencën shkencore ndërkontaktuale që zhvillon UET, Ditët e Studimeve Shqiptare dhe janë mbështetur financiarisht.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	GVJ thekson rëndësinë e mbështetjes financiare të studentëve për nxitjen e novacionit dhe kërkimit shkencor.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mobilitetet e studentëve në Universitet e huaja partnere ne kuadër të programit Erasmus+ KA 1 për shkak të ngjashmërisë së kurrikulave dhe eksperinces që personeli akademik merr gjatë mobiliteteve në institucionet/universitetet partnere. Kjo ndikon në përmirësimin e formave të mësimdhënies dhe nxit rritjen e mobiliteteve tek institucionet partnere.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njojurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njojurive, garantonin mëdise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Praktika profesionale është pjesë e kurrikulës të programit të studimit Master Profesional. Ajo zhvillohet në semestrin e dytë dhe ka 6 ETCS. Mënyra e organizimit të praktikës është e përcaktuar në Nenin 34 të rregullores së UET. Zyra e Karrierës dhe Praktikave në bashkëpunim me departamentin evidenton institucionet ku studeni mund të kryejë praktikën mësimore. Studentët gjithashtu mund të përcaktojnë vetë vendin ku dëshirojnë të kryejnë praktikën.UET nënshkruan marrëveshje me të gjitha organizmat pritës të studentëve për zhvillimin e praktikës dhe mbështet studentët përmes Zyrës së Karrierës dhe Praktikave duke ofruar konsulencë për aplikime dhe shpërndarë informacion për mundësitë e punësimit.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe	Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Praktikave evidenton institucionet e mundshme ku studentët mund të kryejnë praktikën dhe mbështet studentët gjatë gjithë



stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njojurive dhe kompetencave profesionale.	procesit për përfitimin sa më mirë të njojurive dhe kompetencave profesionale.								
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Mbrojtja e praktikës bëhet në data dhe orët e përcaktuara. Praktika profesionale në programin MP Marketing vlerësohet me note në bazë të dosjes së studentit e cila përbëhet nga Marreveshja me organizatën, Relacioni për punën e kryer, vlerësimi i përgatitur nga kompania dhe vlerësimi nga pedagogu përgjegjës. Vlerësimi final jepet nga komisioni i ngritur për vlerësimin e praktikave mësimore.								
Shkalla e përmbushjes së standartit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në bazë të kuadrit rregulator përshkruhet zhvillimi i procesit të diplomimit të studentëve të programit Master Profesional Marketing.Për t'u diplomuar studenti duhet t'i nënshتروhet një provimi të përgjithshëm formimi, ose të mbrojë një punim diplome, i cili të lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit dhe është një punim i pavarur shkencor i studentit.Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e hartimit të një punimi diplome dhe informon studentët për procedurat dhe kriteret e punimit të diplomës.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti. Dheudhëzon studentët me seanca metodologjike dhe sipas një kalendar takimesh të shpallur, duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme.Udhëheqësi i punimit të diplomës planifikon një kalendar komunikimi me studentin dhe përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet kohore të realizimit të tij.



Kriteri 3. Komisioni i posaçëm pér administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ne vend te punimit te diplomës, studenti ka të drejtë të zhvillojë një provim të përgjithshëm formimi, i cili është konceptuar si një rast studimor kompleks, i lidhur ngushtë me profilin studimor të studentit, ku atij do i duhet të aplikojë njohuritë kryesore të përfituarar pér t'i dhënë zgjidhje gjatë kohëzgjatjes së provimit në klasë (150 minuta).
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Studenti propozon Profesorin udhëheqës pasi ka marrë dhe aprovimin e tij. Departamenti shqyrton propozimet e studentëve dhe temën dhe garanton që udhëheqësi i propozuar nga studentët të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit miraton listen e temave dhe udhëheqësve shkencor. Studentët njoftohen pér listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës. Nëse nuk ka pedagogë të brendshëm të përshtatshëm pér të udhëhequr një temë të caktuar, atëherë departamenti ka të drejtë të caktojë një pedagog të jashtëm brenda kritereve të kërkura. Gjatë seancave orientuese studentet asistohen pér përcaktimin e temave të diplomës dhe udhëzime të tjera mbi përbajtjen e saj.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët pér kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Bazuar në RVB studentët asistohen me 10 seanca metodologjike, të përvjavshme gjatë semestrit të dytë pér kryerjen e matjeve, analizave, testeve. Gjithashtu studentet kane ne dispozicion insfrastrukturen e UET se bashku me laboratoret kompjuterike per konkretizimin e punimit te tyre. Pedagogu udhëheqës asiston studentët deri në përfundim të dorëzimit të diplomës.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë pér t'u paraqitur para komisionit.	Nga bisedat me studentët gjatë vizitës në institucion, gjithashtu dhe nga dokumentacioni i dorëzuar nga UET, u konstatua që pedagogët udhëheqës të temave të diplomave, asistonin studentët si pér përpunimin e të dhënavë sasiore ashtu dhe pér përpunimin e të dhënavë cilësore. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë. Studenti dorezon kopjen e firmosur të punimit të diplomës në Departament.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Mbrojtja e diplomës bëhet me gojë dhe studenti vlerësohet me notë sipas komisionit të vlerësimit pér mbrojtjen e diplomave. (Ref pikes 8/8.8 te rregullores se Programit te Studimit) Studenti që merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet pér mbrojtje



	në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezulton mbetës, studenti duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim tjeter.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Sipas Rregullores se Programit studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe listën e plotë të notave, të cilën e tërheq pranë sekretarisë mësimore.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti i programit MP Marketing pajiset me diplomën sipas profilit përkatës, suplementin e diplomës, listën e notave dhe sipas kërkesën nga një kopje të syllabuseve për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit.
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentëve ruhet nga IAL për një periudhë të pacaktuar që nga koha e rregjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkosat ligjore në fuqi.
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të	Dokumentacioni lidhur me personelin e institucionit, përfshirë personelin akademik efektiv dhe atëme kohë të pjesshme ruhet dhe përditësohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila ruan Dosjen Individuale të Stafit Akademik



<p>dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë i cdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>(Evidence 11 – rregullore për burimet njerëzore)</p> <p>Drejtoria e Burimeve njerëzore menaxhon dosjet personale të të gjithë punonjësve, dokumentacionin personal të cdo punonjësi, librezën e punës dhe ndryshimet në dosje për shkak të zhvillimit të karrierës dëshmitë e kualifikimeve të mëtejshme të stafit. Nga vizita në institucion me drejtues të zyrës së burimeve njerëzore, u evidentua mbajtja e të dhënave dhe dosjeve me të gjithë elementët, duke bërë një përzgjedhje me dy anëtarë të stafit dhe u pa saktësia e mbajtjes së informacionit për stafin. Zyra e Burimeve Njerëzore evidenton edhe realizimin e ngarkesës mësimorengë stafi në cdo semestër.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Referuar (<i>Evidencës 11 Rregullore për Burimet njerëzore pika G.I</i>), UET ka parashikuar procedurat për rekrutimin e personelit.</p> <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procedurat për plotësimin e vendeve vakante në strukturë me rekrutimet. Procedura e verifikuar nga dokumentacionet mbështetëse dhe nga vizita në terren përfshin disa hapa të rëndësishme që nga shpallja e vendit vakant, vendosja e kriterevetë pranimit në përuthje me kërkesat për realizimin e ngarkesës mësimore dhe punës kërkimore shkencore, ngritja e komisioneve, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, informacioni përfundimtar dhe vendimi i emërimit. Edhe personeli akademik me kohë të pjesshme i nënshtrohet procesit, përvec pjesës së intervistës.</p> <p>Shpallja e vendit vakant bëhet përmes faqes së ëeb dhe cdo kërkesë, pyetje apo komunikim bëhet gjithashtu përmes e-mailit zyrtar të vendosur në ëebsite.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë pjesë e rregullores së Drejtorisë së burimeve njerëzore. Një element i rëndësishëm përgjatë procedurës është përcaktimi i kritereve të rekrutimit ku një rol të rëndësishëm luan departamenti sipas nevojave të tij për staf akademik dhe miratohen nga Rektori. Kriteret e përgjithshme janë të vendosura në (<i>evidencën 11</i>) dhe janë të larta lidhur me kualifikimet. Dokumenti nuk paraqet kritere specifike apo raste kur mund të ketë kritere specifike, përvec (<i>pikës G. I. 3</i>), raste të vecanta kur mund të punësohen edhe pedagogë pa grada, por menjë përvojë të vecantë në sektorin specific.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që</p>	<p>Ashtu sikurse u argumentua edhe në kriterin 3 të standartit IV.1 kriteret e punësimit përcaktohen në Rregulloren e Universitetit European të Tiranës, (<i>Neni 22 Evidenca 5</i>); dhe (<i>Evidenca 11.. Rregullore për Burimet Njerëzore</i>).</p>



garantojnë përgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përbajtjen e programit të studimit.	Edhe nga vizita në institucion, si dhe nga (<i>evidence 11.1 – shembull i një thirjeje për punësim staf akademik</i>), bëhet e qartë se kriteret në përgjithësi (pa përmendur kriteret specifike) lidhen me departmanetin dhe cfarë kërkon ai nga stafi lidhur me kualifikimet, trainimet, diplomat, specializimet, puna kërkimore, fusha e studimit, gjithnjë që të jetë në përputhje me lëndët strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit, por duke qendruar kryesisht tek kriteret e përgjithshme.			
Shkalla e përbushjes së standardit	<input type="checkbox"/> Përbushjet përcaktuese	<input checked="" type="checkbox"/> Përbushjet pjesërisht	<input type="checkbox"/> Përbushjet kryesisht	<input type="checkbox"/> Përbushjet plotësisht X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Krijimi i mjedisit dhe mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit, përfaqësohet nga nivelet drejtuese të institucionit në përgjithësi dhe nga nivelet drejtuese të departamentit në vecanti. Në të gjitha dokumentet strategjike bazë, Statuti, Strategjia rregullorja e UET, shprehet garancia për lirinë akademike të pedagogut dhe për cilësinë e lartë në proceset akademike dhe infrastrukturë së institucionit, krijimin e një mjedisi nxitës, bashkëpunues dhe zhvillues për profesoratin, studentët dhe stafin e UET. Institucioni gjithashtu anagazhohet për vlerësimin e drejtë të stafit akademik, duke bazuar veprimtarinë në matjen e performances.</p> <p>Referuar (<i>Intervistës me stafin nga vizita në institucion si dhe evidences 44 format dosje e stafit akademik me kohë të plotë</i>). Informimi është një pikë tjetër e rëndësishme lidhur me mundësitet që ofrohen në UET për projekte, kërkim shkencor dhe zhvillim, që krijojnë barazi dhe oportunitete të njëjta për studentët dhe personelin (<i>intervista me drejtues të zyrës së projekteve</i>).</p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e	<p>Personeli që mbulon programin e studimit kualifikohet dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme. Bazuar mbi (<i>evidenë 11</i>), Burimet njerëzore kanë mundësi për tu zhvilluar dhe certifikuar në aspektet e mësimdhënies, kërkimit shkencor, drejtimit dhe menaxhimit dhe komunikimit publik.</p> <p>UET duke u bazuar tek grantet e vëna në dispozicion për</p>



studimit.	<p>kërkimin shkencor mbulon shpenzimet për pjesëmarrjen në konferanca dhe trajnime në vend dhe jasht vendit (<i>Intervista në institucion</i>). Gjithashtu përmenden nga intervista me pedagogët e programit zhvillimi i programeve të trainimit për pedagogët në dy aspekte: si tëpublikohet një paper dhe si të drejtohen grupet kërkimore. Trainimet janë realizuar nga Departamenti i edukimit dhe qendra e metodologjisë.</p> <p>U jepet mundësia dhe informacioni stafit për realizimin e mobiliteteve me programin Erasmus+, por edhe me projekte apo programe të tjera të punës kërkimore shkencore. Si rrjedhim i kësaj mbështetjeje por sidomos edhe bazuar mbi kërkesën e vazhdueshme të vetë stafit për kualifikime, evidentohen disa raste të rritjes dhe zhvillimit të karreires së pedagogëve (<i>intervista me drejtues të zyrës së kërkimit shkencor</i>)</p>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Lidhur me metodat e mësimdhënies, UET ka qenë i përqendruar për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme ato, me qëllim që të përshtaten me tregun, por edhe të jetë lider në fushën e edukimit në Shqipëri (<i>Evidence 2 iUET</i>)</p> <p>UET është angazhuar në metodat innovative që lidhen me e-learning, ose Mësimin elektronike, ndryshe të mësuarit përmes përdorimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit. Në këtë kontekst ndër format e e-learning të evidentuara të përdorura nga programi aktual i studimit janëtë vendosura në platformën LMS, duke mbledhur lehtë dhe shpejt gjithë materialet në një pikë të vetme aksesi për studentët. Aty pedagogët përditojnë në mënyrë të vazhdueshme përbajtjen, si leksione, syllabus, prezantime, detyra në mënyrë të lehtë dhe intuitive, duke mos patur nevojë për njojuri të sofistikuara profesionale. Institucioni paraqet guidën e LMS për pedagogun dhe studentin (<i>evidencat 46.2 dhe 46.3</i>).</p>
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	<p>Burimet njerëzore të institucionit janë angazhuar në mënyrë optimale për përbushjen e objektivave të programit. Ka një shpërndarje të ngarkesave mësimore sipas kualifikimeve në lëndët përkatëse të stafit të departamentit. Gjithashtu lëndët bazë dhe disiplinat karakterizuese, realizohen nga stafi i departamentit dhe fakultetit të ekonomisë, biznesit dhe zhvillimit. Mund të themi se angazhimi i institucionit është apotimal në përbushjen e këtij kriteri, për përbushjen e objektivave të programit.</p>

Shkalla e përbushjes së

Përbushjet

Përbushjet

Përbushjet

standardit	ofrimiushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjetet mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjetet e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Ambjentet fizike përbëhen nga salla leksionesh seminaresh dhe laboratorë për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve të programit. Numri i sallave në dispozicion dhe hapësirat përkatëse janë tëpërshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Ka gjithashtu mjetet mësimore të tjera si salla për praktikën e lëndëve/profesionale, salla për veprimtari promovuese, innolab, zyra e informacionit për studentët, mjetet për aktivitetet e qeverisë studentore. Studentët dhe pedagogët kanë akses në mjetet e bibliotekës, ku ka hapësira të bollshme dhe ka studentë që e frekuentojnë (<i>vizita në institucion</i>).
Kriteri 2. Mjetet mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjetet mësimore të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Çdo sallë e leksioneve është pajisur me mjete audiovizive, projektorë dhe foni. Për cdo leksion mundësohet prezantimi PPT. Laboratorët janë të pajisura me njënumër të konsiderueshëm kompjuterash duke patur parasysh grupet e studentëve. Situata është relativisht e kenaqshme për realizimin e orëve mësimore lidhur me teknologjinë sa u përket pajisjeve dhe infrastrukturës.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjetet e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkuesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në terësi.	Sipas vizitave në institucion pa se laboratorët janë tëpërshtatshëm për realizimin e orëve në raste të nevojshme për programin e studimit. Nuk ka akses në programe të cilat mund të shërbejnë specifikisht degës, por duhet thënë se UET ka inaguaruar gjatë vitit të fundit sallën e re InnoLab, pjesë e projektit Innovation Hub. Kjo nuk është një hapësirë e dedikuar vetëm për programin e studimit, por mund të shërbejë sa herë që ka nevojë për programin e studimit në lëndë specifike, si inovacioni, dhe TV multimedia. Hapësira e tij e dedikuar shërben edhe për klubet studentore aktive të UET. Laboratori i Inovacionit është i pajisur me PC, ambient për të zhvilluar takime/mbledhje, etj.
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të	



teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Aktualisht programi nuk është ndërtuar për të përfthuar aktivitete në laborator dhe nuk ka programe profesionale që mund të përdoren, pasi nuk parashikon ngarkesë me orë laboratorike, por InnoLab është një hapësirë e mundshme për disa aktivitete të tillë në mënyrë të kufizuar.		
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucionë dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet sipas një procedure të qartë të përmendur më lart, në standartin II.5, kriteri 4 dhe që garanton realizimin e praktikës mësimore në mjediset e kompanive/organizatave përkatëse. Për këtë realizohet një marrëveshje e qartë me institucionet që i garanton studentit vendosjen në mjediset e kompanive/organizatave përgjatë gjithë periudhës së praktikës. Institucioni dhe departamenti është përgjegjës për pjesën e praktikës nëauditor ku për rastin e programit të studimit në fjalë realizohen 8 orë gjithsej përgjatë 4 javëve.		
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht		
			X


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sic u përmend edhe në Standartin IV.3, kriteri 2 dhe 3, duke qenë se biblioteka është pjesë përbërëse e mjedisive të UET mundësítë e shfrytëzimit të bibliotekës janë të barabarta për të gjithë studentët. Nga vizitat u vu re se biblioteka frekuentohej nga student në mënyrë të konsiderueshme, duke shfrytëzuar të gjitha mjediset e saj. Biblioteka përmban gjithë literaturën e nevojshme dhe të domosdoshme të lidhur me programet e studimit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standardeve të bibliotekave, ka punonjës të trainuar lidhur me organizimin dhe menaxhimin e bibliotekave.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme	<i>Numri i titujve është i kufizuar në bibliotekën e UET, tek titujt në Shqip për programin e studimit.</i> Numri i titujve në anglisht për programin e studimit është i



<p>dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>kënaqshëm, por duke patur parasysh nivelin e masterit profesional, duhet fokusuar sidomos në titujt në Shqip përlendet karakterizuese dhe lëndët bazë. Psh, u kërkua në vizitën në institucion libër në shqip i Kërkimit Marketing dhe Marketingu i shërbimeve.</p> <p>Një përditim me literaturat më të fundit realizohet përmes abonimit në platformat elektronike, ku ka akses nërrjetin e bibliotekave sipas sistemit COBIS, si edhe aksesi në bibliotekat online. Gjatë vizitës në bibliotekë u provua aksesi në këto sisteme online dhe u verifikua infrastruktura e bibliotekës, ndaj mund të vlerësojmë se ka përshtatshmëri me veprimtaritë mësimore sipas natyrës së programit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Sic u përmend më sipër Biblioteka e UET u jep mundësi të gjithë studentëve të aksesojnë në bibliotekat online pa pagesë, përmes kompjuterave desktop të vendosur aty.</p> <p>Programet kompjuterike dhe pajisjet teknike, shërbimi ËIFI janë në nivele të kënaqshme në përgjithësi dhe në dispozicion të programit të studimit për të gjithë studentët pa kufizime.</p> <p>Biblioteka e UET ishte e abonuar dhe në librarinë elektronike Sage & Ebsco dhe Questia dhe aksesi në këto platforma ishte pa pagesë për studentët. Biblioteka UET ka funksionalë 12 PC të vëna në dispozicion të studentëve. Të gjitha PC ishin të pajisur me softëare-t përkatës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të gjitha programeve të studimit, si rrjedhim edhe të programit të Masterit Profesional në Marketing, përmes procesit të blerjes së literaturave në formë dhe mënyra të ndryshme.</p>	<p>Bazuar mbi (<i>evidencat 45, 45.2 dhe 13</i>)UET ka një plan për përmirësimin e burimeve të bibliotekës dhe përditimin e fondit ekzistues në mbështetje të gjitha programeve të studimit, si rrjedhim edhe të programit të Masterit Profesional në Marketing, përmes procesit të blerjes së literaturave në formë dhe mënyra të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të</p>	<p>Biblioteka u vihet në dispozicion studentëve në oraret e qëndrimit të studentit në universitet, 9:00 – 20:00 dhe të shtunën deri në 17:00. Gjatë sezonit të provimeve orari i bibliotekës është më i zgjatur. Kapacitetet e bibliotekës me sallën përkatëse është i përshtatshëm dhe në mbështetje të zhvillimit të procesit mësimor, numrit të studentëve.</p>



saç.			Përmbyshjet kryesish	Përmbyshjet pëlhodësish
Shkalla e përbushjes së standardit			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET është i organizuar dhe menaxhuar në mënyrë të tillë që në mbështetje të gjithë veprimtarisë së tij funksionon sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit. Ky system përbëhet nga dy sisteme paralele UMS dhe LMS. Ky i dyti është në shërbim primar të studentëve me synim kryesor rritjen e cilësisë së shërbimit të tyre në cdo hallkë të procesit dhe sigurisht në këtë kontekst edhe të stafit pedagogjik, mësimor kërkimor dhe stafit administrativ. (<i>evidence 46.2 dhe 46.3</i>). Përmes sistemit UMS mirëmenaxhohet procesi administrativ, institucional duke ofruar gjithë funksionalitetin e nevojshëm për ofrimin e shërbimit dhe informacionit të nevojshëm për studentët, për programin e studimit, kurrikulen, planin mësimor, syllabuset, sistemin e vlerësimit dhe informacion mbi vlerësimet në cdo kurs dhe diplomimin. Pjesa e sistemit LMS për studentët dhe pedagogët ofron shërbimin përmes llogarive log in përkatëse, ku vendoset gjithë informacioni dhe merret nga studentët.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i menaxhimit të informacionit menaxhon informacionin lidhur me personelin akademik që lidhet kryesisht me syllabuset, programet, mësimdhëni dhe lidhjen me faqen e pedagogut



Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Aksesi i dedikuar në informacionin e LMS-është i garantuar përmes username dhe passëord për secilin pedagog dhe për secilin student. (procesi u shpjegua më lart).								
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Çdo hap i procesit mësimor paraqitet me informacion të ofruar nga UMS, nëpërmjet bazës së të dhënave “Dokumenta UET”, ndërsa studentët kanë akses mbi informacionin e programit të studimit për lëndët përkatëse siç regjistrohen në platformën LMS. Përmes platformës aktuale mundësohet edhe Komunikimi interaktiv midis pedagogëve dhe studentëve, që gjithashtu komunikojnë edhe përmes e-mailit zyrtar UET.								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi LMS garanton monitorim dhe ndjekje të përdorimit të sistemit nga pedagogët dhe studentët si dhe raportim të performancës së studentëve, respektimin e afateve të pedagogëve, lidhur me detyrat, vlerësimet, hedhjen në sistem të informacioneve të tjera dhe gjenerimin e aksesimit në kohë reale. Platforma LMS është një mjet që përdoret edhe nga Komisioni i Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë, pasi me anë të tij mund të monitorohet dhe mbarëvajtja e të gjithë procesit akademik.								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Duke studiuar Web-site të UET shohim se ky kriter përbushet pasi ka një informacion mbi programet e studimit, stafin akademik të programit CV-të e stafit dhe aktivitetet që realizon UET. Informacioni është përkthyer plotësisht dhe i vendosur në dy gjuhë.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------



<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport finanziar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme përmbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Ligji i arsimit të lartë 80/2015 krijon gjithë hapësirat ligjore për ndërtimin e mekanizmave të duhur për menaxhimin financiar të institucionit dhe pjesëve përbërëse të tij.</p> <p>Menaxhimi financiar është një komponent themelor i mbarëvajtjes së institucionit. Lidhur me programin e studimit, (<i>evidence 49</i>) paraqiten kostot për student në programet e studimit në përgjithësi, por është një tregues i ngjashëm edhe për programin e studimit të Masterit Profesional ne Marketing. Gjithashtu referuar evidences 50, ajo paraqet disa burime të ardhurash për institucionin që do të mbështesin edhe mbarëvajtjen e këtij programi. Burimi kryesor i të ardhurave janë tarifat e studimit.</p> <p><i>Nuk paraqitet një plan i mbështetjes financiare përmbarëvajtjen e programit të studimit. Plani i mbështetjes finaciare duhet të përfshijë parashikimin përmbarëvajtjen e programit të studimit dhe sponsorizime apo përfshirje në projekte të mundshme, të cilat të mbështesin kostot e programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative përmirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet përbibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituarra dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjera sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në nivel institucioni realizohet një plan finanziar në kuadër të planit strategjik të institucionit. Pasqyrat financiare hartohen sipas ligjit dhe paraqesin kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenëzimeve.</p> <p>Përvec (<i>evidencës 49 dhe 50</i>) lidhur me disa burime të ardhurash dhe kostot mesatare për student, nuk jepen të dhëna përtë evidentuar planifikimin financiar të shpenëzimeve përvitet e ardhshme.</p> <p>Sidoqoftë, burimet e të ardhurave të shprehura dhe gjatë intervistës në institucion janë veç tarifave edhe pjesëmarrja në projekte të kërkimi shkencor me shuma financiare të konsiderueshme përpunën kërkimore shkencore.</p> <p><i>Sygjerohet planifikim financiar për programin e studimit që të paraqesë një parashikim të numrit të studentëve bazuar mbi të dhëna të kaluara dhe prirjet përmbarëvajtjen e studimit, e si rrjedhim parashikimi i të ardhurave, si dhe shpërndarja e këtyre të ardhurave nga programi konkret i studimit apo nga burime të tjera, përmblimin e kostove të stafit, shpenëzimeve operative dhe shpenëzimetë tjera. Planifikimi duhet të përbajë përqindjen e këtyre kostove specifisht për programin.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e</p>	<p>Legjislacioni në fuqi detyron institucionin të realizojë audimitin e pasqyrave financiare në mënyrë të përvitshme, përmes EEI shpk, e cila përbush kushtet përkryerjen e</p>



financimit dhe efektivitetin financierar të tij. Raporti financierar përban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributete të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	ekspertizës. Audituesi ligjor jep pozicionin e tij mbi performancën , pozicionin financier dhe standaret e kërkuar të kontabilitetit.								
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Nuk ka dokumentacion për të verifikuar raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike, përvèc burimeve të të ardhurave për viteit 2013-2018 dhe kostove për student 2015-2018.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Bazuar në përpjekjet e institucionit për të rritur të ardhurat jo vetëm nga studentët dhe tarifat e tyre, por edhe nga shërbimet dhe grantet nga projektet, si burim i rëndësishëm, (intervista dhe vizita në institucion), gjykojmë që institucioni ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njojjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>UET ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin e dytë të studimeve universitare në perputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njojuri, aftësi dhe kopetanca profesionale e analitike.</p> <p>Kriteret e pranimit të studetëve përcaktohen nga MASR në përputhje me udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore për vitin akademik përkatës.</p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejtë të njëjtë për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Rregullorja e Programit të studimit përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve dhe studentëve të programit.</p> <p>(Regullore Programi i Studimit MP Marketing)</p> <p>(Regullore e UET)</p>
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njojjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësish të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njojjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen qartë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e UET.</p> <p>Ky informacion bëhet publik nëpërmjet faqes zyrtare të UET dhe është lehtësish i aksesueshëm.</p>
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përparr çdo viti akademik kritere të veçanta për përgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të	Kriteret për përgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional përcaktohen nga MASR për vitin akademik përkatës dhe publikohen nga institucioni në fillim të cdo viti akademik.

studimeve.				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit përmes ëebosit te tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë.				
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrit paraqitet qartë në rregulloren e UET si dhe atë të programit të studimit. Ky informacion vihet në dispozicion nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe sekretaria e institucionit.	Informacion i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrit paraqitet qartë në rregulloren e UET si dhe atë të programit të studimit. Ky informacion vihet në dispozicion nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe sekretaria e institucionit.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pësshme	UET informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pësshme nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së përkujdesit për studentët, zyrës së këshillimit të karrierës, sekretarisë dhe departamentit përkatës të programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	UET informon studentët lidhur me vlerësimin e dijeve nëpërmjet Rregullores së Programit të studimit dhe ku paraqiten: Sistemi i vlerësimit; forma e vlerësimit; forma e kontrollit të dijeve; kushtet për hyrjen në provim; organizimin e tyre; shpalljen e rezultateve; ankimimin dhe përmirësimin e notes. Në Syllabusin e secilës lëndë ka informacion të detajuar lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve. Studentët e aksesojnë informacion dhe në distance përmes sistemit LMS dhe fizikisht pranë zyrës së sekretarisë



	ose koordinatoreve të programit të studimit specifik. Në fillim të çdo semestri, syllabusi dhe kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve shpjegohen nga pedagogu.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	UET u vendos në dispozicion studenëve udhëzues të shkruar mbi kriteret e procedurat e punimit të diplomës. Gjithashtu sic u sqarua ne seksionin III gjatë periudhes së përgatitjes të punimit te diplomes zhvillohen seancat metodologjike dhe pedagogu udhëheq studentët për punim e diplomës.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Konfirmojmë se Institucioni informon periodikisht përmes udhëzuesve specific dhe takimeve specifike për të siguruar kontigjente të reja studentësh në vitet që vijojnë për të garantuar ardhëmërime e programit MP në Marketing.. Gjatë vizitës së institucion, GVJ u informua se në fillim tëçdo viti të ri akademik, UET zhvillon "Javën e Orientimit", nëpërmjet të cilës studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambjentet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Gjithashtu edhe faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale jepin informacion për të interesuarit mbi programet e ardhshme të studimit.
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënët dhe mundësítë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut informon studentët në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, nëpërmjet rregullores së programit të studimit.Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve në ëebsitin e UET dhe u lejon studentëve pët të marrë informacion lidhur me organizimin e plotë të studimeve të këtij programi.Gjithashtu, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Master Profesional në Marketing nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe pedagogët, dhe gjendet i publikuar në sistemin UET LMS ku çdo student është i



	regjistruar.			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit, procesin mesimor, rregulloren e brendshme, regulloren e studimeve, procedurat në lidhje me procesin mësimor etj. Këto informacione dhe dokumenta merren në zyrën e sekretarisë dhe koordinatoreve, dhe gjenden në version elektronik në sistemin UET-LMS, dhe në ëbsite-n e institucionit. Gjithashtu në fillim të secilit semestër studentët pajisen me të gjithë syllabuset e lëndëve.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Karrierës në bashkëpunim me Zyrën e kujdesit për studentët, informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për ti orientuar në tregun e punës. Aktivitetet e punësimit të studentëve përfshijnë Panaire pune - UET open days; Biznese te ftuar ne auditor; Aktivitete Alumni, dhe bordet e bordit te punes. Institucioni përmes dy zyrave përgjegjëse inkurajon studentët të marrin pjesë dhe informon ata mbi zhvillimet në tregun e punës.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjërë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët kanë mundësi të aksesojnë informacion të plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij përmes zyrës të kujdesit ndaj studentëve, sekretarisë dhe kordinatorëve përkatës, por edhe online nëpërmjet UET-LMS ku pedagogë e student shkëmbejnë materiale të ndryshme lidhur me lëndën dhe programin e studimit.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësish i arritshëm nga studentët edhe në distancë	E konfirmojmë se: Informacioni rreth ecurisë së programit, detyrimeve akademike për të përbushur programin, afateve kohore në funksion të përbushjes së programit, monitorohen nga një mirëmenaxhim i brendshëm. UET disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit (UET-LMS) dhe është i arritshëm nga studentët jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe në distance. Informacioni në lidhje me procesin mësimor është lehtësish i disponueshëm përmes sistemit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet <input type="checkbox"/>	Përbushet pjesërisht <input type="checkbox"/>	Përbushet kryesisht <input type="checkbox"/>	Përbushet plotësisht <input checked="" type="checkbox"/> X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e

studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	<p>Në analizën mësimore të departamentit të Menaxhimit e Marketingut gjenden të pasqyruara statistikat vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në programin MP Marketing.UET disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Master Profesional ne Marketing. Nëpërmjet Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.</p> <p>Sipas (<i>Dokumentit nr. 27 -Cilesia ne hyrje dhe dalje e studenteve te programit, Mp Marketing</i>), dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarine mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi sipas profileve përkatëse për dy vitet akademikeishte:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019;</p> <p>Profili “Inovacion” 19 studentë;</p> <p>Profili “Marrëdhënie publike politike” 2 studentë;</p> <p>Profili “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh” 6 studentë;</p> <p>Profili “Turizëm” 9 studentë;</p> <p>Totali 36 studentë</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020;</p> <p>Profili “Inovacion” 13 studentë;</p> <p>Profili “Marrëdhënie publike politike” 1 studentë;</p> <p>Profili “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh” 8 studentë;</p> <p>Profili “Turizëm” 7 studentë;</p> <p>Profili “TV Multimedia” 2 studentë;</p> <p>Totali 31 studentë</p> <p>Për sa i përket numrit të të diplomuarve në këtë program studimi rezulton se:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar gjithse për të gjitha profilet 18 studentë;</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e	UET disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë,



<p>studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të viti akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit. Për progamin Mp në Marketing ,nuk rezultonin studentë të transferuar.</p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit të brendshëm Institucioni ruan të dhënat personale të studentëve. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave kryen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e brendshme të UET. I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në sistem dhe aksesoher vetëm përmes studentit sipas numrit të matrikulimit të tij. Sistemi mban të dhëna për prezencën, vlerësimin dhe stadin ku ndodhet një student me programin që ndjek.</p>								
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësish të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Cdo e dhënë për cdo student është e garantuar të mbrohet, dhe kanë akses vetëm personi dhe persona të autorizuar. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nëpërmjet sistemit të manaxhimit të informacionit UMIS, një program informatik i cili administron dhe përpunon të dhënat e studentëve nga sekretaria, drejtuesit dhe personat e autorizuar në kohë reale.</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartoje raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Departamenti harton raportin vjetor të analizës mësimore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe punësimin e tyre. Departamenti reflekton mbi gjendjen aktuale dhe bazuar në këto të dhëna propozon masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e

përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre irregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët kanë mbështetjen e UET për tu angazhuar në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Nga takimi në institucion u informuan se studentët organizohen në Keshillin Studentor, në Focus Grupe për vlerësimin e procesit mësimor dhe dhënë ide për përmirësimin e vazhdueshme në përputhje me nevojat e tyre si dhe në procesin e anketimit për vlerësimin për lëndët dhe pedagogun.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësish të verifikueshme e të matshme.	Konfirmojmë se pjesëmarja e studentëve në vendimmarrje është e natyrshme aspak e sforcuar dhe fiktive. UET garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe në këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik. Studentët organizohen në Këshilla Studentore ku shprehin mendimin e tyre për problematika të ndryshme lidhur me ceshtje të programeve mësimore dhe procesit mësimor. Gjithashtu KSBC organizon cdo muaj focus grupe me studentët, përmes të cilave mendimet dhe propozimet e studentëve u paraqiten departamentit dhe merren masat përkatëse korrigjuese. Nga takimi me studentët mësuam se ata janë në djeni të këtyre strukturave dhe i mbështesin ato.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.	Programi i studimitështë organizuar duke marrë në konsideratë aftësinë e studentëve për të përvetësuar njohuritë. Në vlerësimin e ngarkesës akademike janë mbajtur në konsideratë si marrja e informacionit teorik ashtu dhe atij praktik përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të shpërndarë gjatë semestrit në raportin 60:40. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e plotë të studentëve gjatë gjithë kursit. Departamenti është bashkëpunues me studentët për të lehtësuar praktikat e plota të njohjes së lëndëve dhe ka procedura joburokratike të njohjes së studimeve të mëparshme.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Studentët në mënyrë indirekte përfshihen në rishikimin e syllabuseve apo të programit MP. Kjo përfaktin se studentët angazhohen në vlerësimin e përformancës së pedagogëve dhe në dobinë e disiplinës akademike përmes pyetësorëve. (<i>referuar rregullores së programit dhe detyrimit që kanë studentët të përfshihen në plotësimin e pyetësoreve</i>)



Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët përmes Fokus Grupeve dhe Anketimeve të realizuara nga institucioni mund të japid mendimin e tyre mbi kryerjen e procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve Gjithashtu, nga vizita në institucion u informuam se pas çdo provimi organizohen dhe kryhen seancat sinquese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësish të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Disa nga njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë Departamenti, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimit, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimor; Sekretaria mësimore ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi; Zyra e karrierës ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit. UET ka krijuar procedura në shërbim të informimit të studentëve në përputhje rregullatoren e institucionit.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	UET ka një sistem online për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. UET-LMS ofron informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Baza e të dhënave për studentin përfshin edhe emailin si një mjet për informim dhe këshillim nga zyrat përkatëse dhe kordinatoret. Gjithashtu ka ngritur zyrën e kujdesit ndaj studentëve, asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e	Zyra e karrierës luan rol të rëndësishëm në këshillimin dhe orientimin e studentëve në mënyrë të vazhduar dhe periodike për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Përmes




karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	panaireve të organizuara, projekteve bashkëpunuese me biznesin, bordin e Alumni, UET shkëmben informacion lidhur me njohuritë dhe aftësitë që ofron programi i studimit dhe profilet në tregun e punës.								
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoritetet e drejtues të përkatëse	Zyra për këshillimin e karrierës dhe Shoqata Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit MP Marketing. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka bordin e tij të tregut të punës me 11 anëtarë, të cilët sigurojnë informacion dhe ua vënë në dispozicion organeve dhe autoritetet e drejtues të përkatëse.								
Shkalla e përbushjes së standartit	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="background-color: #666; color: white;">Nuk përbushet</th> <th style="background-color: #666; color: white;">Përbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: #666; color: white;">Përbushet kryesisht</th> <th style="background-color: #666; color: white;">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center;"></td> <td style="text-align: center;"></td> <td style="text-align: center;"></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMITMASTER

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke përbushur kërkesat e Ligjit për ARsimin e Lartë në RSH dhe gjithashtu kërkesat e akteve rregullatore institucionale. Referuar (Statutitë UET në nenin 11 dhe 16) jep orientimet e përgjithshme se cilat janë dhe si do	UET ka politika struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke përbushur kërkesat e Ligjit për ARsimin e Lartë në RSH dhe gjithashtu kërkesat e akteve rregullatore institucionale. Referuar (Statutitë UET në nenin 11 dhe 16) jep orientimet e përgjithshme se cilat janë dhe si do



me aktet rregullatore institucionale.	<p>të vendosen këto politika struktura dhe procedura. Ai përcakton njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si siguruese dhe zbatuese të monitorimit dhe raportimit të përhershëm. (<i>evidence 2 statuti i UET</i>).</p> <p>UET ka ndërtuar gjithashtu Manualin për sigurimin e cilësisë (<i>Evidence 37.1</i>) i cili përshkruan politikat strukturat dhe procedurat në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore dhe statutit e rregullores së UET</p> <p>(<i>Evidencia 37.3 – strategjia për sigurimin e cilësisë</i>), tregon për politikat se si UET parashikon sigurimin e cilësisë dhe procedurat përkatëse.</p> <p>(<i>Evidencia 37.2</i>) gjithashtu paraqet planin e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i ndërtuar në kuadër të projektit QAINAL me fonde të programit Erasmus të Bashkimit Europjan.</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>KSBC, është ngritur në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit (<i>evidence 30 – mbi individët e angazhuar në KSBC</i>). Komisioni, duke patur akses në të dhënat institucionale, vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore të UET- it.</p> <p>Në KSBC angazhohet një ekspert i jashtëm, për t’iu përgjigjur nevojës së institucionit për t’u konsultuar me aktorë të jashtëm. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë një strukturë tjeter e rendësishme është dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), roli i së cilës është të zhvillojë politikat, strategjitë, proceset dhe udhëzimet, në funksion të ritjes së cilësisë në UET, si edhe të monitorojë zbatueshmërinë korrekte të tyre nga njësítë akademike dhe administrative.</p> <p>Studentët përfshihen në procesin e monitorimit të cilësisë përmes plotësimit të anketave, me qëllim që të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme puna mësimore, Departamenti i Menaxhimit dhe marketingut si cdo njësi tjeter në UET, organizon vlerësimin e brendshëm të procesit mësimor nga studentët nëpërmjet anketimit në fund të çdo semestri.</p> <p>Nga vizita në institucion një nga komponentët themelorë si pjesë e procesit të cilësisështë edhe Funksioni i Bordit të tregut te punes i cili kontribuon ne permiresimin e kurrikules duke dhënë feedback nga kërkesa e tregut të punës, por duke qenë edhe funrizuesit e pare per punesimet e studentëve në UET.</p>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për	UET përmes proceseve te vlerësimit të jashtëm të akreditimit realizon sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. Të



<p>sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e kahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>gjitha programet e studimit që ofrohen, i nënshtrohen vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues. Referuar (<i>Evidencia 5 për akreditimin institucional</i>) paraqet vlerësimin e jashtëm të institucionit. Gjithashtu programi i studimit ka realizuar vlerësimin e jashtëm në vitin 2018 dhe ka marrë vlerësim pozitiv dhe akreditim për 6 vjet. Si rezultat i kërkesave për ndryshime nga feedback nga tregu është ndryshuar programi dhe kërkuar akreditimi aktual (<i>intervista në institucion me Dekan dhe përgjegjës departamenti</i>).</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Duke u bazuar në(<i>evidencat 37.1, 37.2 dhe 37.3</i>) dhe intervistat në institucion, me anëtarë të KSBC mund të themi se politikat e institucionit mbi cilësinë janë të qarta dhe procedurat realizohen dhe ndiqen periodikisht, duke synuar një kulturë të përgjithshme në rang institucional.</p> <p>Sipas intervistave, njëfaktor themelor që ndikon në këtëculture është komunikimi dhe strukturimi i marrëdhënies me Bordet e tregut të punës, të cilat rrjedhin prej marrëdhënies me UET Alumni.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1" data-bbox="568 1129 1388 1302"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngrënjësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Departamenti është njësia bazë që ka të drejtën dhe profesionalizmin e përmirësimit, ndryshimitapo propozimit të kurrikulave të reja. Stafi i departamentit, përballetëtregut të punës, literaturave bashkëkohore, studentëve, biznesit, nevojës për përmirësim/ndryshim dhe përmirësime të vazhduarështë gjithnjë në kërkim të mënyrave tëpërmirësimit, rregullimeve në kurrikula, përshtatje të tyre, përmirësimi të syllabuseve të vecanta, etj; Qëllimi është studenti, dijet dhe njojuritë e tij si dhe përhithjen e tyre të plotë nga tregu kombëtar dhe ndërkombëtar. Përgjegjësit e grup lëndëve kanë gjithashtu</p>



	njërol të vecantë së bashku me koordinatorin e programit i cili merr feedback nga problematikat e studentëve.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Bazuar në Manualin e Sigurimit të cilësisë (<i>evidence 37.1</i>) mund të identifikojmë disa mekanizma dhe procese formale për shqyrtimin dhe mbikqyrjen periodike të programeve. Ky process mbikqyrjeje dhe përmirësimi ndodh në fillim të cdo viti akademik, ku kërkohet të identifikohen përmirësimet e programeve dhe rishikime bazuar mbi të dhëna të ecurisë gjatë viti të kaluar. Procesi është i natyrshëm përgjatë ecurisë me procesin e mësimdhënies
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	(<i>Pika 2.4 evidenca 37.1</i>) paraqet Metodat e sigurimit të cilësisë ku përfshihen: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Monitorimi i procesit të mësimdhënies nga instancat drejtuese; ✓ Vlerësimi i procesit të mësimdhënies nga përgjegjësi i departamentit, kolegët, studentët (Vlersimi nga studentët ka një format të caktuar dhe të struktuar (<i>evidence 40</i>); ✓ Vlerësimi i punës kërkimore shkencore të stafit; ✓ Marrja e informacionit të detajuar mbi problematikat e procesit apo kërkesat e studentëve nëpërmjet focus grupeve (<i>vizita dhe evidence shtesë – pyetjet për focus grupet</i>); ✓ Përfshirja e studentëve në organet drejtuese dhe mbledhjet e departamentit.; <p>Procesi i folloë-up siguron mbajtjen e të dhënave për ecurinë e stafit, dhe jep mundësinë e raportimit dhe analizës. Supozohet që vlerësimet e performancës sëstafit të ruhen në mënyrë elektronike dhe të qëndrojnë si raporte tek dosja në Burime njerëzore, ku ekzistonin vetëm në disa raste.</p> <p><i>GVJ sygjeron që të ketë një evidentim më të mirë të të dhënave dhe informacionit lidhur me këtë process, i cili është shumë i vlefshëm si instrument matës për ecurinë e stafit, e si rrjedhim edhe të programit të studimit.</i></p>
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Bazuar në intervistat në institucion, GVJ u informua se gjithë dokumentacioni mbi procesin e vlerësimit dhe ndryshimet e këruara apo propozuara nëprogramet e lëndëve, apo të tjera, por edhe analizat mësimore, kalon nga poshë lart, pra nga departamenti drejt senatit dhe rektoratit i cili mbi këtë bazë merr vendimet, dhe finalizon procesin me një plan masash (në fund të vitit akademik). Kjo krijon tendencën e natyrshme të përmirësimit të cilësisë, mësimdhënies, të gjithë sistemit të shërbimit në funksion dhe për studentët.



	Megjithatëky informacion lidhur me zbatueshmérinë dhe raportimin nuk u arrit të verifikohet gjithashtu përmes dokumentacionit (evidencave), apo në intervistë me studentët.
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Bazuar mbi intervistat në institucion raportet e vlerësimit për programin e studimit përfshijnë rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive, por nuk ka evidenca për të konfirmuar të paktën formatet që duhet të kenë raportet e vlerësimit, që të lejojnë identifikimin e përfshirjes së këtyre elementeve në raportet e vlerësimit. <i>Sygjerojmë ndërtimin e formave formale, të miratuara në department dhe të monitoruara dhe zbatuara nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë.</i>
Shkalla e përbushjes së standardit	Përmirësuar kryesisht Përmirësuar plotësisht <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> X <input type="checkbox"/>

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i brendshëm i programit është proces që kryhet periodikisht, nga KSBC në nivel institucional, kalon nëdisa etapa dhe është institucionalizuar përmes metodologjisë së përdorur. Këtë informacion që rezulton si output i procesit dhe që prek dhe përfshin te gjitha hallkat e tij, institucioni e transmeton tek departamentet, të cilat merren me zbatueshmérinë në përmirësimin e elementeve që lidhen me programet specifike.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumenteve të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Sigurimi i brendshem i cilësisë bëhet kryesisht në këto mënyra: a) nëpërmjet mbledhjes së informacionit nga studentët përmes instrumentave tëpyetësorëve të drejtuar studentëve të cilat plotësohen cdo semester dhe focus grupeve të studentëve; b) nëpërmjet vlerësimit të performancës së cdo pedagogu në cdo vit akademik; c) komunikimi periodic me Bordet e Tregut të Punëspër



	<p>tëmarrë feedback nga tregu dhe për të sjellë në këtë mënyrë përmirësimë që do të përshtasin me tregun e punës;</p> <p>Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me KSBC, me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional që ka përgjegjësinë institucionale. Senati si organi më i lartë akademik i cili ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet nga Grupi ad-hoc i vlerësimit të brendshëm, i cili ka ndjekur procedurat bazua në ligj dhe akte nënligjore si dhe në kuadrin rregullator të institucionit. GVB ka ndërtuar raport bazuar mbi specifikat e institucionit</p>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	<p>Metoda dhe instrumente të ndryshme vlerësimi janë përdorur në këtë drejtim, në përgjithësi, por dhe për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit Master profesional në Marketing me profile. Këto metoda përfshijnë sondazhet e studentëve, intervista në panairin e karreirës, komunikim dhe kontakt me Alumni të UET.</p> <p>Metoda të caktuara vlerësimi dhe proceset janë të përcaktuara në manualin e sigurimit të cilësisë. Në këtë mënyrë vlerësohet performanca e programit të studimit, si gjatë zhvillimit të moduleve me anketimin në përfundim tëçdo semestri për të gjitha modulet, ashtu edhe në dalje, me anketimet e karrierës dhe të diplomuarve.</p> <p>Metodat e drejtpërdrejta të përfshira në manualin e sigurimit të cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Teste të standardizuara; ✓ Dëgjime në auditor; ✓ Vlerësimi me pikë; ✓ Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; ✓ Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; ✓ Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; <p>Gjatë intervistës në institucion u përmendën si instrument edhe kontrolllet nga eprori për personelin akademik të kategorisë lektor dhe asistent lektor</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfshira nga ky program.</p>	<p>Metodat e tërthorta të përdorura janë sic u përmendën edhe tek seksioni 3 anketimet me studentët, fokus grupet me studentët, vlerësime të brendshme të stafit akademik të departamentit, vlerësime nga drejtimi dhe njëri-tjetri si edhe vlerësime nga tregu i punës përmes Bordeve të Tregut të punës i përbërë nga UET ALumni.</p>				
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="background-color: black; color: white; padding: 2px;">Përbushjet kryesishët</th> <th style="background-color: black; color: white; padding: 2px;">Përbushjet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="text-align: center; padding: 2px;">X</td> <td style="text-align: center; padding: 2px;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushjet kryesishët	Përbushjet plotësisht	X	X
Përbushjet kryesishët	Përbushjet plotësisht				
X	X				

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas Statutit (<i>evidencia 2</i>), rregullores (<i>evidencia 3</i>) dhe evidencave të lidhura me cilësinë (<i>evidencia 37.1, 37.2, 37.3</i>) UET parashikon dhe garanton disa politika dhe procedura të mirëpërcaktuara për të përfshirë në proces si aktorë të brendshëm ashtu dhe ata të jashtëm. Kështu KSBC përbëhet nga staf i brendshëm nga departamentet dhe fakultetet, staf me eksperiencë dhe gjithashu një ekspert i jashtëm (<i>evidencia – përbërja e KSBC</i>). Bordet e tregut të punës përfshijnë në procesin e vlerësimit Alumni dhe aktoët jashtë UET që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me tregun e punës.</p> <p>Angazhimi përmes projekteve të rëndësishëm e fonde të BE që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë (projekti TEMPUS ‘ENCHASE’ dhe Erasmus+ <i>QAinAL</i>, (<i>evidence 37.4 dhe 37.5</i>), janë tregues të angazhimit dhe përfshirjes së aktorëve të jashtëm.</p>



<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitet, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Aktet rregullatore të institucionit të përmendura në kriteret e mësipërme (<i>evidence 2 dhe evidence 3</i>) paraqesin përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, si edhe të individëve dhe palëve të treat të përfshira në proces.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë dhe kryesore përfshihen në vlerësimin e cilësisë, duke qenë baza e zbatimit të procesit si në aktivitetet e përditshme ashtu edhe në aktivitete periodike, të raportimeve, mbledhjeve etj. Përmes tyre përfshihen anëtarët e personelit akademik, por gjithashtu KSBC përfshin në proces anëtarët përmes metodave të vetvlerësimit dhe vlerësimit në grupe të njëri-tjetrit (<i>intervista me stafin e programit dhe KSBC</i>). Studentët e programit përfshihen përmes vlerësimeve periodike dhe plotësimit të pyetësorëve. Garancia për përfshirjen e këtyre aktorëve jepet përmes dokumentave bazë, statuti, rregullorja, rregullorja e programit të studimit, dhe manuali i sigurimit të cilësisë, strategjia e sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shhangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve</p>	<p>Në përzgjedhjen e anëtarëve të KSBC merren parasysh disa kritere të cilat lidhen me kompetencat profesionale, paanshmërinë, mundësitet për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dheshkallën e nevojshme të njojjes të anëtarëve të Komisionit.</p> <p>Anëtarët gjithashtu nuk duhet tëjenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it. Keto kritere garantojnë mosdiskriminimin dhe respektimin e integritetit akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të jalin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Ekspertë të jashtëm, Alumni dhe përfaqësues të tregut të punës përmes bordeve jalin mendime të cilat kanë cuar në propozime për përmirësim të programit bazuar mbi feed-back-un e tyre.</p> <p>UET ka ndërtuar një linjë komunikimi shumë të mirë sidomos me BTP. Bazuar mbi intervistën në institucion të njësisë Alumni dhe karrierës, ky organizim dhe komunikim me qëllim përmirësimin e programit përmes përfitimeve që vijnë nga Alumni, ka disa pikë të forta.</p> <p>Kështu Bordet kanë presidence dhe Bord drejtues Honorifik ku bëjnëspjesësata që janë diplomuar më parë pranë UET. Kontaktet gjenden përmes Festivalit të Alumni ku fokusi kryesor është alumni.</p> <p>Rrjeti alumnika gjeneruar BTP me 11 anetarë. Funksioni i</p>



	Këtyre bordeve têtregut të punësështë në kontribuimin në permiresimin e kurrikules si edhe si funrizuesit e parë për punësimet. Mbledhjet dhe komunikimet bëhen siç shpejgohet nga zyra Alumni.6 muaj pasi diplomohen studentet merren të dhënat e tyre të punësimit, procesi realizohet në bashkëpunim me departamentin, përmes telefonatave me bursistet. Edhe pse humbja e gjurmëve të këtyre individëve me vlerë për UET është e mundshme, UET arrin që t'i mbajë të dhënat përmes komunikimeve me njeri-tjetrin, kontaktit përmes shefave të departamentit dhe rrjeteve sociale. Ka dy takime formale me BTP (janar ose shkurt) një takim eshte ne Open Week. Përmes gjithë këtyre procedurave dhe gjithashtu komunikimit të vazhdueshëm rrjeti Alumni dhe BTP japinkontributin për përmirësimin e programeve.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th><th>Përbushet pjessërisht</th><th>Përbushet kryesisht</th><th>Përbushet plotësisht</th></tr> <tr> <td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjessërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjessërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të janë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Transparenca e politikave, strategjive dhe organizimit në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë, bëhet Brenda institucionit përmes komunikimit të brendshëm dhe gjithashtu përmes dokumentave strategjike, ku secili mund të ketë akses edhe përmes sistemit. Transparenca për studentët dhe aktorë të jashtëm bëhet përmes Faqes së Ëeb, ku gjenden dokumentat strategjike të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga intervista në institucion, të pyetur mbi shpërndarjen e informacionit lidhur me vlerësimet e programit të studimit, u pa se këto nuk publikohen, për shkak të të dhënavë sensitive lidhur me opinionet dhe vlerësimet individuale, por ato diskutohen në departamente nëformën e raporteve dhe gjithashtu u vihen në dispozicion autoritetëve dhe organeve drejtuese. Takimet individuale të autoritetëve drejtuese me stafin, kur ka raste të problematikave të vecanta, janë politikë UET. Rezultatet nuk publikohen për publikun e gjërë.



Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Duke qenë se synimi i gjithë procesit dhe realizimit të monitorimit të cilësisështë përmirësimi i programeve dhe përbushja e pikave të dobëta të identikuara, ose hapësirave nga objektivat e synuara të programit, masat merren për këto përmirësime në nivel departamenti, duke u bazuar edhe tek drejtimi dhe orientimi i përgjegjësit të departamentit dhe grup seksionit të lëndëve. Nuk ka ndonjë evidencë për plan masash të zhvilluar konkretisht, por ky përfundim del nga vizita në institucion.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimitarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Dokumentet dhe procedurat e ndjekura synojnë në rritjen e efektivitetit dhe ndikimit në procesin e cilësisë. Nuk ka matje të këtij efektiviteti, por shihet se proceset janë përmirësuar gjatë kohës, nga viti në vit dhe kjo e ka bërë procesin më efektiv.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimitari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Veprimitaritë informuese dhe ndërgjegjësuese janë kryesisht të shpërndara përmes rregulloreve, vetë studentëve përgaqësues në strukturat si senati dhe KSBC, javës orientuese dhe këshillit studentor.
Shkalla e përbushjes së standartit	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Marketing”, me profile, “Turizëm”, “Inovacion”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh”, “TV Multimedia”, "Marrëdhënie Publike Politike”” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Master Profesional në Marketing me profile shton në treg mundësitetë për afirmimin e specialistëve të marketingut të cilët do të orientohen në treg sipas



- kërkesave të bizneseve, kryesisht duke u fokusuar tek bizneset në sektorë të shërbimit si Turizmi, Mediat dhe organizata politike, shërbime e produkte digitale dhe novatore;
2. Ky program studimi është ndërtuar duke u bazuar në rishikimin e programit të mëparshëm akredititimi i të cilit ka shërbyer si një bazë e mirë për ndërtimin e këtij programi, bazuar edhe në sygjerimet nga marrëdhëniet e institucionit me botën e biznesit;
 3. Ndërtimi i Bordeve të Tregut të Punës përmes rrjetit të ALUMNI dhe ruajtja e një marrëdhënie komunikimi për të shkëmbyer informacion mbi nevojat e tregut, mundësi punësimi për studentët si edhe përmirësimin e kurrikulës;
 4. Niveli profesional dhe kërkimor shkencor i stafit akademik duke përfshirë si staf me eksperiencë ashtu edhe staf të ri dhe kërkues, mbështetet edhe nga pjesëmarrja në projekte dhe grantet specifike për projekte kërkimore të stafit;
 5. Struktura të mirëpërcaktuara për matjen e performancës së stafit, matjen e cilësisë në shumë aspekte të saj si dhe për komunikimin dhe marrëdhënien me studentët;

b. Pika të dobta:

1. Pika e dobët themelore lidhet me përzgjedhjen e një grupei të lëndëve në programin e studimit në dy kategoritë: lëndët bazë dhe lëndët me zgjedhje.
 - ⇒ Lënda Bazë “Metoda kërkimi të avancuara” përsëritet në përmbajtje tek lënda karakterizuese “Kërkimi marketing”. Lëndë bazë e Programit Master Marketing duhet të jetë brenda ideologjisë formuese praktike në Marketing. “Metodat e kërkimit të avancuar” është lëndë që i shërben formimit në një master shkencor, pra e panevojshme në këtë program studimi professional;
 - ⇒ Lëndët ndërdisiplinore në Profilin Turizëm dhe Inovacion, nuk thellojnë njohuritë dhe nuk zhvillojë tërësisht aftësitë profesionale të studentit në profilet përkatëse. Vetëm lenda e profilit Turizëm “Menaxhimi i Mikëpritjes dhe Turizmit” nuk justifikon të gjithë profilin. Në grupin e lëndëve të Inovacionit gjenden lëndë të palidhura me profilin;
2. Duke pasur në vëmendje që programi MP Marketing me 5 profile, ofrohet në gjuhën shqipe, ka një literaturë të kufizuar në gjuhën shqipe, ndërkohë që në programin MP nuk është e detyruar gjuha e huaj. Mungesa e kësaj literature në bibliotekë lidhur me titujt përkatës të lëndëve të programit mund të krijojë problem për studentët;
3. Planifikimi financiar jo i detajuar lidhur me programin e studimit, me parashikimin e të ardhurave dhe kostove specifike për periudhat e ardhme;

Rekomandime

1. Të rishikohet mundësia e zëvendësimit të disa lëndëve të cilat nuk janë të domosdoshme ose nuk krijojnë vlerën e duhur për profilizimin e studentëve dhe përballjen e tyre me tregun e punës. Specifikisht:
 - ⇒ Propozojmë zëvendësimin e lëndës aktuale bazë, me lëndë bazë formuese në marketing si: lënda “Menaxhim strategjik Marketing” ose “Planifikim



- Marketing”, ose një modul me lëndë të kategorisë strategji/planifikim/kërkim i aplikuar/strategji marke;
- ⇒ Aktualisht disa nga lëndët e vendosura në profile konsiderohen nga GVJ si karakterizuese, si psh, “Komunikim i Integruar Marketing” ose “Marketing Ndërkombeṭar”;
 - ⇒ Sugjerojmë që është domosdoshmëri të thellohen njoħuritë në menaxhimin dhe marketingun e sherbimeve turistike me lëndë specifike që lidhen me Turizmin e Qëndrueshém, Marketingun e turizmit etj. Gjithashtu në profilin inovacion mund tē vendosen lëndë të lidhura me krijimin e shoqërisë së informacionit, sipermarrjet inovative dhe start-up;
2. GVJ sugjeron tē pasurohet literatura bazë e detyruar me tekste në gjuhën shqipe, gjithashtu tē pasurohet fondi i bibliotekës me titujt e përfshirë në kurrikulat mësimore tē lëndëve. Në këtë kontekst sygjerohet tē përzgjidhet me kujdes literatura bashkëkohore dhe tē bëhet një përkthim profesional i tituve kryesorë në gjuhën shqipe;
 3. Në tē ardhmen mund tē konsiderohet përfshirja e laboratorëve sidomos në profilet inovacion dhe TV multimedia, pasi janë profile me lëndë me natyrë praktike dhe nevojë pér formim me software përkatës, si dhe mund tē mbështeten nga laboratorët përkatës dhe infrastruktura tashmë e ngritur pranë UET;
 4. Përvec stafit tē brendshëm tē angazhuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, rekomandojmë tē vazhdojë angazhimi i stafit tē specializuar tē jashtëm me përvojë aplikative në fushën e marketingut;

Evaluation Process of the study program “Professional Master in: "Marketing", with profiles: "Tourism"; "Innovation"; "Project Management and Evaluation"; "TV Multimedia"; "Political Public Relations"

- a. **Strengths and affirmations:**
6. The Professional Master study program “Marketing with profiles” has its impact in the market adding opportunities for affirming marketing specialists who will be market-oriented according to business requirements on service sectors such as tourism, media and political organizations, digital and innovative services and products;
 7. This study program is built on the review of the previous program whose accreditation has served as a good basis for building this program, based also on suggestions from the institution's relationship with the business world;
 8. Labor Market Boards are built through the Alumni Network and a strong relationship is maintained to share information on market needs, job opportunities for students, and curriculum improvement;

9. The professional and scientific level of the academic staff including both experienced and new staff and researchers is also supported by project participation and specific grants for staff research projects;
10. Well-defined structures for measuring staff performance, measuring quality in its many aspects as well as for communication and relationships with students;

b. Weaknesses

5. The basic weakness relates to the selection of a set of subjects in the study program in two categories: core subjects and electives.
 - The content of the basic course "Advanced Search Methods" is repeated in the content of the "Marketing Research". The core of the Professional Master of Marketing must be within the formative practical ideology of Marketing. Advanced research methods is a subject that serves more to the formation of a scientific master's degree, therefore unnecessary in this professional study program. Other courses that are basic for a professional marketing program are recommended;
 - Interdisciplinary courses in the Tourism and Innovation Profile do not deepen knowledge and do not fully develop the student's professional skills in the respective profiles. Only the subject of Tourism: "Hospitality and Tourism Management" does not justify the whole profile. In the Innovation course, there are courses unrelated to the profile;
6. Bearing in mind that MP Marketing program with 5 profiles is offered in Albanian language, there is limited literature in Albanian language, while foreign language is not required in MP program. The lack of this literature in the library regarding the relevant subject titles of the program can create problems for students, who not necessary always use English literature;
7. Non-detailed financial planning related to the study program, with specific revenue and cost forecasts for future periods;


Recommendations:

1. Review the possibility of replacing some courses that are not necessary or do not provide the necessary value for the profiles of students and their confrontation with the labor market. Specifically:

==> We propose replacing the current core course with a marketing core as a Strategic Marketing Management or Marketing Planning module, or a module in the category of strategy / planning / applied research / brand strategy;

==> At present some of the subjects listed in the profiles are considered by GVJ to be in another category, as characterizing for the program, such as Integrated Marketing Communication or International Marketing;

==> We suggest that it is necessary to deepen knowledge in the management and marketing of tourism services with specific subjects related to Sustainable Tourism, Tourism Marketing



etc. Also on the innovation profile can be subjects related to information society creation, innovative ventures and start-ups;

2. The GVJ suggests enriching the compulsory basic literature with texts in Albanian language, enriching the library fund with the titles included in the subject curricula. In this context, it is suggested to carefully select contemporary literature and make a professional translation of the main titles in Albanian;
3. In the future, the inclusion of laboratories may be considered especially in innovation profiles and multimedia TVs, as they are profiles of practical nature and need training with relevant software. They actually may be supported by relevant laboratories and infrastructure already established at UET;
4. In addition to in-house staff engaged in teaching and research, we recommend continuing the hiring of specialized external staff with applied marketing experience;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesishht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTAMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANACIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Ermelinda KORDHA

Dr. Ana BUHALJOTI

